



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i
Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Departamenti i politikave zhvillimore për Bujqësi
Autoriteti Menaxhues

PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2013

PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2013

MASA 2

RISTRUKTURIMI I POTENCIALIT FIZIK NË SEKTORIN AGRO-RURAL

MASA 3

UJITJA E TOKAVE BUJQËSORE

MASA 4

**INVESTIMET NË PËRPUNIMIN DHE MARKETINGUN E
PRODHIMEVE BUJQËSORE**

MASA 8

PËRKRAHJE PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT LOKAL

Përmbajtja

Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin Agro-Rural	5
1. Arsyeshmëria e masës.....	5
2. Objektivi i përgjithshëm	5
3. Lidhja me masat tjera të përfshira në program	5
4. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë.....	6
5. Shtrirja gjeografike	6
6. Kërkesat e përbashkëta për investime	6
7. Shpenzimet e pranueshme	6
8. Shpenzimet e papranueshme.....	7
9. Shkalla e përkrahjes.....	7
10. Buxheti vjetor i masës dhe ndarja sipas nënmasave.....	7
11. Treguesit	8
■ Nënmasa: Ekonomitë bujqësore për prodhimin e qumështit	9
■ Nënmasa: Ekonomitë bujqësore për prodhimin e vezëve	14
■ Nënmasa: Prodhimet e mishit të viçit dhe broilerëve	17
■ Nënmasa: Ekonomitë bujqësore prodhuese të mjaltit	22
■ Nënmasa: Sektori i frutave	25
■ Nënmasa: Sektori i vreshtave për rrush të tryezës	30
■ Nënmasa: Sektori i perimeve	33
■ Nënmasa: Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese	37
■ Nënmasa: Mekanizëm bujqësor	39
MASA 3	43
Ujitja e tokave bujqësore.....	43
1. Arsyeshmëria e masës.....	43
2. Objektivat specifike	43
3. Lidhje me masat e tjera të përfshira në program	43
4. Kriteret e pranueshmërisë	43
5. Shtrirja gjeografike	43
6. Investimet e pranueshme	44
7. Dokumentet e nevojshme	44
8. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike	44
9. Shpenzimet e papranueshme janë.....	44
10. Kriteret e përzgjedhjes	45
11. Thirrja për aplikim	45
12. Treguesit e monitorimit dhe vlerësimi	45
13. Mjetet financiare	45
MASA 4	46
Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Prodhimeve Bujqësore.....	46
1. Arsyeshmëria e masës.....	46
2. Objektivat specifike	46
3. Lidhje me masat e tjera të përfshira në program	46
4. Kriteret e pranueshmërisë.....	46
5. Shtirja gjeografike.....	47
6. Kriteret specifike të pranueshmërisë	47
7. Kriteret e përbashkëta me të drejtë mbështetje dhe investimet e pranueshme për sektor ..47	

8.	Investimet e pranueshme	47
a.	Prodhimet e qumështit	47
b.	Mishi dhe përpunimi i mishit	48
c.	Sektori i përpunimit dhe marketingut të frutave dhe perimeve duke përfshirë edhe prodhimin e verës.....	49
d.	Investimet e pranueshëm për të gjitha nën sektorët e Masës 4.....	50
9.	Shpenzimet e pranueshme për marketing për të gjithë nënsektorët	51
10.	Dispozitat tjera në lidhje me shpenzimet e pranueshme në nënmasat e Masës 4.....	51
11.	Shpenzimet e papranueshme.....	51
12.	Kriteret e përzgjedhjes	51
13.	Niveli i mbështetjes	53
14.	Dokumentet përcjellëse	53
15.	Thirrja për aplikim	53
16.	Treguesit e monitorimit	53
17.	Mjetet financiare:	54
MASA 8	55
Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal.....		55
1. Arsyeshmëria e masës.....		55
2. Objektivat		55
3. Lidhja me masat tjera të përfshira në program		55
4. Lloji i investimit të pranueshëm.....		55
5. Dokumentacioni i nevojshëm		56
6. Niveli i mbështetjes intensiteti i ndihmave.....		56
7. Shpenzimet e papranueshme:.....		57
8. Kriteret e përzgjedhjes të projekteve të GLV		57
9. Përfituesit e mundshëm.....		58
10. Thirrja për aplikim		58
11. Treguesit e monitorimit		58
12. Mjetet financiare		58
Tabela e buxhetit të masave të propozuara		59
Kontrata për financimin e projekteve investuese të Zhvillimit Rural		65
Model për përgatitjen e planit të biznesit për projektet e përkrahura nga MBPZHR		71
Model i treguesve për projekte		79
Procedura e prokurimit		89

MASA 2

Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin Agro-Rural

1. Arsyeshmëria e masës

Gjendja e përgjithshme dhe performanca e sektorëve të prodhimit bujqësor ndikohet nga struktura e fermave shumë të vogla dhe niveli i lartë i fragmentimit të tokave, shfrytëzimi i kufizuar i teknikave të prodhimit bashkëkohore, kapacitetet e ujitjes dhe deponimit (ruajtjes). Aktualisht ka një mungesë të përgjithshme të sasisë dhe cilësisë së lëndës së parë (qumështit, mishit, vezëve, pemëve dhe perimeve), për të përmbushur nevojat e sektorit të përpunimit dhe tregut të brendshëm.

Sektorët tjerë me një potencial të madh për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës në viset rurale (bletaria, bimët mjekuese), kanë një traditë të gjatë në Kosovë, por mungojnë mjetet financiare për të investuar në pajisje, sigurim të ushqimit dhe tregtim (marketing). Mungesa e makinerisë bujqësore është një dobësi e zakonshme për të gjithë sektorët bujqësorë.

Aftësia konkurruese e fermave dhe prodhimeve të tyre është e kufizuar për shkak të efikasitetit të ulët të prodhimit dhe kostos së lartë të prodhimit. Standardet shtetërore në fermë (shëndeti publik, mbrojtja mjedisore, mirëqenia e kafshëve, siguria në punës etj.) nuk zbatohen plotësisht. Arsyet kryesore për këtë gjendje janë mungesa e investimeve në makineri dhe teknologji bashkëkohore, të cilat do të mundësonin arritjen e standardeve më të mira.

Bazuar në SWOT-analizën e freskuar të sektorit të bujqësisë dhe në vlerësimin e nevojave nënmasat/sectorët në vijim janë përzgjedhur për përkrahje dhe do të zbatohen në kuadër të Masën 2:

- Përkrahja për sektorin e qumështit;
- Përkrahja për sektorin e vezëve;
- Përkrahja për sektorin e mishit (trashja e viçave dhe rritja e broilerëve);
- Përkrahja për sektorin e bletarisë;
- Përkrahja për sektorin e pemëve (molla dhe pemët e imta);
- Përkrahja për sektorin e rrushit të tryezës;
- Përkrahja për sektorin e perimeve (prodhimi në serra dhe në fushë të hapur);
- Përkrahja për sektorin e frutave të malit dhe bimëve mjekuese;
- Përkrahja për sektorin e makinerisë bujqësore.

2. Objektivi i përgjithshëm

- Përmirësimi i strukturës së fermave dhe rritja e efikasitetit;
- Rritja e prodhimit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.

3. Lidhja me masat tjera të përfshira në program

Kjo masë lidhet me Masën 4 (Investimet në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore). Masa 2 do të përkrahë investimet në ferma të cilat duhet të shprijnë në rritjen e:

- prodhimit,

- përmirësimin e sigurisë së ushqimit dhe
- cilësinë e lëndës së parë të nevojshme për industrinë e përpunimit.

4. Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

- Aplikuesit e Masës 2 janë persona fizik ose juridik;
- Personat juridik duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e bizneseve në Kosovë;
- Aplikuesit duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e fermës;
- Aplikuesit duhet të jenë pagues të rregullt të obligimeve tatimore (për personat fizik tatimin në pronë, për personat juridik tatimin për biznes);
- Aplikuesit e projekteve investuese në vlerë mbi 20.000 € duhet të dorëzojnë plan biznesi sipas formatit të kërkuar nga MBPZHR si pjesë e aplikacionit. Në rast të punëve të ndërtimit dhe/ose rindërtimit, dokumentacioni teknik me plan të ndërtimit dhe/ose rindërtimit, duhet të përgatitet dhe të dorëzohet bashkë me planin e biznesit;
- Përfituesit e projekteve në të cilat niveli i përkrahjes me mjete publike është 30,000 € apo më shumë, pas nënshkrimit të kontratës me Agjensionin për Zhvillimin e Bujqësisë duhet të regjistrojnë ndërmarrje bujqësore në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve;
- Vlera minimale e projektit për të cilin aplikohet duhet të jetë 5.000 €, përveç për nënmasen e bletarisë dhe perimeve në fushë të hapur;
- Përfituesi do të marrë obligimin që pas nënshkrimit të kontratës të marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga projekti i Bankës Botërore, para se të bëhet pagesa përfundimtare;
- Aneksë të kësaj mase, përpos udhëzuesit për përpilimin e planit të biznesit, janë edhe kontrata, formulari dhe për mbledhjen e indikatorëve.

5. Shtrirja gjeografike

Në tërë territorin e Kosovës.

6. Kërkesat e përbashkëta për investime

- Projekti investues duhet t'i parashohë prodhimet bujqësore nga sektorët e përzgjedhur - qumësht, vezë, mish, pemë dhe rrush, perime, mjaltë, bimë mjekuese, makineri bujqësore, siç specifikohet hollësisht të nënmasat;
- Vetëm investimet e bëra, pas nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme për rimbursim nga Agjensioni i Zhvillimit të Bujqësisë. Shpenzimet e studimit të fizibilitetit/shërbimet e tjera të këshillimit për përgatitjen e aplikacionit pranohen edhe nëse ato janë bërë para nënshkrimit të kontratës;
- Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik. Këto janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjensionin e Zhvillimit të Bujqësisë.

7. Shpenzimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme janë:

- ndërtimi ose renovimi (por jo blerja) e pronës së paluajtshme;
- blerjen e makinerisë së re dhe pajisjeve (në përputhje me vlerën e tregut);
- blerja e materialit fidanor për ngritjen e pemishteve dhe vreshtave të reja;
- shpenzimet administrative (projektimi, plani i biznesit dhe pajisja me leje dhe licenca të nevojshme për investim) në lartësi deri në 3% nga totali i investimit të pranueshëm, por jo më shumë se 2000 €.

8. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme janë:

- shpenzimet e kamatës;
- artikujt tashmë të financuar në kuadër të ndonjë kornize tjetër;
- blerja e tokës apo ndërtesave;
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerive;
- humbjet nga këmbimi i valutave;
- tatimet, përfshirë TVSH-në, përveç nëse përfituesi (apo partnerët e përfituesit) nuk mund t'i kthejnë ato dhe rregulloret e në fuqi nuk ndalojnë mbulimin e tatimit;
- kreditë për palët e treta;
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në natyrë;
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimit);
- shpenzimet operative;
- ndalesat bankare, shpenzimet e garantuesit dhe ndalesat tjera të ngjashme;
- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera.

9. Shkalla e përkrahjes

Përkrahja maksimale publike për projekte të pranueshme është 65 % e shpenzimeve të pranueshme.

Vlera maksimale e investimit të pranueshëm është e përkufizuar për secilën nënmasë.

Një aplikues mund të dorëzojë vetëm një aplikacion në këtë masë, rrjedhimisht nënmasë. Në të njëjtin aplikacion mund të përfshihen më së shumti dy nënmasa, prej të cilave njëra duhet të jetë patjetër nga nënmasa e mekanizimit bujqësor dhe kjo duhet të jetë në pajtim me nënmasën tjetër.

Vlera maksimale e mjeteve publike që mund të përfitojë një aplikues nuk mund të tejkalojë shumën prej 80,000.00 €. Nëse tejkalohet vlera maksimale e përkrahjes publike, shpenzimet tjera i bartë pala përfituese.

Përfituesit duhet t'i përmbahen kushteve të kontratës së nënshkruar me Agjensionin e Zhvillimit të Bujqësisë të MBPZHR. Me këtë kontratë parashihet që përfituesi duhet ta zhvillojë aktivitetin e njëjtë se paku tri vjet pas pranimit të pagesës së fundit dhe kjo do të verifikohet me kontroll nga ana e MBPZHR-së.

10. Buxheti vjetor i Masës 2 dhe ndarja sipas nënmasave

Buxheti vjetor i Masës 2 është: 6.650.000 €

I ndarë sipas nënmasave të përkrahjes si më poshtë:

- Sektori i qumështit	1,000,000 €
- Sektori i vezëve	300,000 €
- Sektori i mishit	700,000 €
- Sektori i bletarisë	250,000 €
- Sektori i pemëve	1,200,000 €
- Sektori i rrushit të tryezës	200,000 €
- Sektori i perimtarisë	1,400,000 €
- Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekues	300,000 €
- Sektori i makinerisë bujqësore	1,300,000 €

Shënim:

Në rast të mosshfrytëzimit të buxhetit në një nënmasë, Autoriteti Menaxhues ka të drejtë të shpërndajë pjesën e mbetur në nënmasa tjera.

11. Treguesit

Lloji i treguesit	Treguesi	Pikësnyimi	
Outputi	Numri i ndërmarrjeve të përkrahura		
	Prej të cilave	Sektori i qumështit	20
		Sektori i vezëve	9
		Sektori i pemëve	54
		Sektori i rrushit	7
		Sektori i mishit	30
		Sektori i perimtarisë	167
		Sektori i bletarisë	24
		Sekt. i makinerisë bujqësore	130
		Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese	20
		Nr. i bizneseve fillestare të përkrahura	461
	Vëllimi i gjithëmbarshëm investimit	10.500.000 €	
Rezultati	Rritje e sipërfaqes së tokës së punuar (ha)		
	Rritje u numrit të fermave modernë		
Ndikimi	Prodhimet bujqësore shtesë si rezultat i përkrahjes publike		
	Vende të reja punë të krijuara	3600	

■ Nënmasa

Ekonomitë bujqësore për prodhimin e qumështit

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Prodhimi i qumështit në Kosovë është shumë i rëndësishëm dhe shumë 'i ndjeshëm' për shkak të strukturës së fermave. Shumica e fermave janë me numër të vogël të krerëve qumështore dhe stallat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e qumështit cilësor.

Standardet e mjedisit, mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit në përgjithësi nuk janë arritur ende. Të gjithë këta faktorë duhet të përmirësohen në mënyrë që të kemi prodhime cilësore e të frytshme të qumështit të cilat do të kishin gjasa më të mira për të konkurruar në treg.

2. Objektivat specifike

- Ndërtimi i stallave modernë;
- Përmirësimi i infrastrukturës përkatëse për përgatitjen e ushqimit të kafshëve, të atyre për mjelje, duke synuar arritjen e standardeve të mëposhtme:
 - higjiena dhe siguria e qumështit,
 - cilësia e qumështit,
 - shëndeti i kafshëve,
 - mirëqenia e kafshëve;
- Ndërtimi i deponive të plehut.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

- a) Të jenë të regjistruar si fermerë në Regjistrat e Sektorit për Identifikim dhe Regjistrim të Kafshëve (I&R) pranë Agjensisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV);
- b) Aplikuesit duhet të kenë lopë ose dele dhe dhi të shënjuara me matrikuj të Republikës së Kosovës dhe të posedojë Listën për verifikimin e tyre për çdo krerë të lëshuar nga AUV-së;
- c) Kafshët e importuara nga shtetet e BE-së duhet të regjistrohen në Listën e verifikimit të gjedhëve, rrjedhimisht ripërtpësve të imtë në AUV, por mund të mbajnë matrikujt e vendeve të BE-së;
- ç) Të kenë së paku 15 lopë qumështore ose 100 dele, rrjedhimisht dhi;
- d) Dëshmi për posedimin e të paktën 0.5 ha të tokës bujqësore (ara, livadhe dhe kullota), për çdo krerë lope, ose 0,05 ha për krerë deleje apo dhie. Toka mund të jetë në pronësi ose e marrë me qira për të paktën 3 vjet.

4. Investimet e pranueshme për lopë qumështore

Investimet e pranueshme për lopë qumështore janë:

4.1. Ndërtimi i një stalle për lopë me dimensione se paku 20,40m x 10,40m, për mbajtjen e kafshëve në tipin e lidhur me infrastrukturë të brendshme, si më poshtë:

- Grazhdet;
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe ujëpirëset;
- Vendqëndrimet për kafshë të rritura;
- Vendqëndrimet për viça;

- Dyert ballore - copë 2;
- Dyer anësore (sipas nevojës);
- Dritaret me pozicion horizontal;
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës;
- Sistemi i ventilimit;
- Dhoma e qumështit.

4.2. Ndërtimi i stallës së re të lopëve me dimensione se paku 20,40m x 10,40m për mbajtjen e kafshëve në tipin e lirë me infrastrukturë të brendshme të mëposhtme:

- Grazhdet;
- Shtretërit;
- Kanali për largimin e plehut dhe sistemi për largimin e plehut;
- Aneksi për mjelje;
- Dhoma e qumështit;
- Vendqëndrimet për viça;
- Dyert ballore - copë 2;
- Dyer anësore (sipas nevojës);
- Dritaret me pozicion horizontal;
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës;
- Sistemi i ventilimit.

4.3 Pajisje për mjelje, ftohje, ndërtim dhe renovimi i dhomave të qumështit:

- Sistemi i mjeljes (sistemi i mbyllur apo mjeltore);
- Pajisje për ftohje të qumështit (laktofriz), me kapacitet, 500, 1000 dhe 2000 l;
- Dhoma e qumështit (ndërtim i ri), sipas të dhënave teknike;
- Renovimi i dhomës së qumështit që përfshinë:
 - dyshtemenë e shtruar me pllaka,
 - mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m,
 - furnizim më ujë të pijes.

4.4 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:

- Deponi e plehut të stallës, (i lëngjet dhe i ngurtë), sipas kriterëve të MBPZHR,
- Deponi për silazh (sistemi horizontal) dhe
- Deponi për ushqim voluminoz (hangarë).

Sipas kriterëve të përcaktuara nga MBPZHR-ja.

5. Investimet e pranueshme për ripërthypësit e imtë

Investimet e pranueshme për ripërthypësit e imtë janë:

5.1 Ndërtimi i stallës së re me dimension se paku 20,40m x 10,40m me këtë infrastrukturë të brendshme:

- Grazhdet për të ushqyer;
- Sistemi për furnizim me ujë dhe ujëpirëset;
- Vendqëndrimet për kafshë të rritura;
- Vendqëndrimet për qengja apo keca;
- Dyert ballore – 2 copë;
- Dyer për dalje emergjente - 6 copë;
- Dritaret me pozicion horizontal;
- Sistemi i ventilimit.

Dimensionet e stallës dhe infrastrukturës së brendshme janë të specifikuara në udhëzuesin e përgatitur nga MBPZHR-ja.

5.2 Pajisje për ruajtje dhe përpunim të bulmetit, ndërtim dhe renovim të dhomave të qumështit / bulmetit:

- Dhoma e qumështit / bulmetit (ndërtimi i ri), sipas të dhënave teknike të cilat do të jenë të specifikuara në udhëzues;
- Ndërtimi apo renovimi i dhomës së qumështit / bulmetit që përfshinë:
 - a) dyshemenë e shtruar me pllaka,
 - b) mure të veshura me pllaka në lartësi deri 1.8 m,
 - c) furnizim më ujë të pijes dhe
 - ç) sistem të kanalizimit.

5.3 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:

- Deponi e plehut të stallës (për plehun e ngurtë), sipas kriterëve të MBPZHR-së dhe
- Deponi për ushqim voluminoz (hangarë).

6. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nënmasën

- a) Dëshmia kadastrale e tokës bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) në pronësi ose një kopje e kontratës për qiramarrje të tokës bujqësore për të paktën tre vjet pas aplikimit;
- b) Kopja e kontratës për dorëzimin e qumështit te përpunuesi (nëse e posedon);
- c) Dëshmi për anëtarësimin në shoqatën e prodhuesve të qumështit, respektivisht shoqatën e dhentareve (nëse ai/ ajo është anëtar i shoqatës);
- ç) Dëshmi mbi kualitetin e qumështit në gjashtë muajt e fundit nga AUV vetëm për lopë qumështore;
- d) Kopjen e listës së verifikimit të bagëtive të lëshuar nga Sektori për identifikimin dhe regjistrimin në AUV për të gjitha kafshët.

Aplikuesit e përzgjedhur po ashtu duhet të dorëzojnë edhe:

- a) Lejen e ndërtimit të lëshuar nga organi kompetent komunal;
- b) Pëlqimi i komunitetit në mjedisin ku ndërtimi i stallës është planifikuar;
- c) Dëshmi mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor (nga MMPH) vetëm për ata që aplikojnë për ferma me mbi 100 gjedhe ose mbi 500 ripërtpës të imtë

7. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

7.1 Për lopët qumështore:

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës së re sipas pikëve 4.1 ose 4.2 është 25.000 €;
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 4.3 është: 20.000 €;
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 4.4 (për përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse) është: 10.000€.

7.2 Për nënmasën e ripërtpësve të imtë (dele dhe dhi):

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit në ndërtimin e stallës sipas pikës 5.1 është: 20.000 €;
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit sipas pikës 5.2 (pajisje për ruajtje dhe përpunim të bulmetit) është më së shumti 10.000 €;

- Kufijtë më i lartë i shpenzimeve të pranueshme të investimit sipas pikës 5.3 (infrastrukturës përcjellëse) është më së shumti 10.000 €;
- Për të gjitha investimet intensiteti i ndihmës publike është 65 % i shpenzimeve të pranueshme. Çdo shpenzim tjetër përtej kufijve të paraparë do të konsiderohet si jo i pranueshëm.

8. Kriteret e përzgjedhjes

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë	
1	Projekte që përmbajnë	Ndërtimi i stallës së re	Po	25
			Jo	10
		Përmirësimi i infrastrukturës përkatëse të fermës	Po	20
			Jo	10
		Deponia e plehut	Po	15
			Jo	10
2	Numri i kafshëve	100-300 krerë dhenë/dhi kurse lopë qumështore 15-25	15	
		Mbi 300 krerë dhenë/dhi ose mbi 25 lopë qumështore	10	
3	Pronësia mbi tokën (çdo aplikues duhet të këtë së paku 0,5 ha/lopë ose 0,05 ha/dele apo dhi)	Më shumë se 50% në pronësi	10	
		50% ose më shumë e tokës me qira	5	
6	Anëtar i shoqatës së prodhuesve të qumështit ose asaj të deltarëve	Po	5	
		Jo	2	
7	Mosha e fermerit	Nën 40 vjet	5	
		40 vjet dhe më shumë	3	
8	Gjinia (e aplikuesit të regjistruar në regjistrin e fermerëve)	Femër	5	
		Mashkull	3	
	Totali		100	

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve në fund të listës, atëherë parësi kanë projektet që kanë numër më të vogël të kafshëve. Në qoftë se edhe numri i kafshëve është i njëjtë, atëherë përparësi ka ai që ka aplikuar më herët.

9. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

10. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Input	1.000.000 €.	
Output	Nr. i fermave të përkrahura	30
	Vëllimi i përgjithshëm i investimit (në €)	1,428,571
Rezultati	Numri i stallave të reja	20
	Numri i fermave me standarde të përmirësuara	17
	Numri i fermave me deponi të reja të plehut	15
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar (ekuivalente me vende të punës me orar të plotë)	

11. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmasë janë:

1,000,000 € të parapara si vijon:

- a) 600.000 € për lopë qumështore dhe
- b) 400,000 € për ripërthypësit e imtë.

■ Nënmasa

Ekonomitë bujqësore për prodhimin e vezëve

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Sektori i shpezëtarisë, veçmas prodhimi i vezëve për konsum është shumë i rëndësishëm dhe mjaft 'i ndjeshëm' në Kosovë për shkak të strukturës së fermave.

Shumica e fermave janë të vogla dhe posedojnë numër të vogël të krerëve, stallat nuk janë shumë të përshtatshme për prodhim, teknologji e vjetruar dhe ndikim negativ në ambient. Të gjithë këta faktorë duhet të përmirësohen për të shtuar prodhimtarinë e prodhimeve të mira e cilësore.

Përmirësimi i aftësive konkurruese të fermave për prodhimin e vezëve dhe përshtatja për treg do të arrihet nëpërmjet:

- Përmirësimi të teknologjisë dhe
- Ruajtjes së ambientit.

2. Objektivat specifike

- Ndërtimi i stallave të reja për pulat vojse;
- Përmirësimi i cilësisë së veve për plotësimin e nevojave të tregut dhe
- Mbrojtja e mjedisit duke aplikuar teknologji të reja.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

Aplikuesit duhet të kenë së paku 3000 pula vojse në prodhimtari.

4. Investimet e pranueshme

4.1 Ndërtimi i stallës së re me kapacitet: së paku 3.600 pula vojse, me pajisje:

- Sistemet e ventilimit;
- Sistemet e ujit brenda në fermë;
- Mekanizmi për largimin e plehut në fermë;
- Kafazet për vendosjen e pulave;
- Sistemi i ushqimit;
- Sistemi i ndriçimit;
- Sisteme të monitorimit të temperaturës të lagështisë dhe ndriçimit.

4.2 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë dhe pajisje:

- Makinë për klasifikimin e vezëve;
- Dhoma frigorifer;
- Sistemet për deponimin e plehut të stallës (gropa septike).

5. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nënmasën

- Dëshmi mbi numrin dhe origjinën e pulave (fatura e furnizimit);

- Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore të pulave të lëshuar nga AUV;
- Dëshmi mbi anëtarësimin në shoqatën e shpezëtarëve (nëse është anëtar i shoqatës).

Përfituesi duhet të sjellin edhe:

- Lejen e ndërtimit të lëshuar nga organi përkatës i komunës;
- Pëlqimin e komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës;
- Dëshminë e vlerësimit të ndikimit mjedisor (nga MMPH) vetëm për ata që aplikojnë për ferma me më shumë se 10.000 pula vojse.

6. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për të investuar në ndërtimin e stallës së re sipas pikës 4.1 është 40.000 €;
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme nga pika 4.2 është: 20.000 €.

7. Kriteret e përzgjedhjes

Nr.	Lloji i kriterit		Kateg. e kriterit	Pikë
1.	Projekti që përmban	Ndërtimin e stallës	Po	30
			Jo	10
2.		Blerja e pajisjeve dhe përmirësimi i cilësive të veve	Po	20
			Jo	10
			Mbrojtja e mjedisit (deponia e plehut)	Po
Jo	5			
3.	Ndërtim i stallës për pula vojse me kapacitete	3,000-20,000	10	
		mbi 20,000	5	
4.	Lloji i prodhimtarisë (mënyra e mbajtjes)	Në dysheme	10	
		Në kafaz	5	
5.	Anëtar i shoqatës së shpendëtarëve	Po	10	
		Jo	5	
6.	Mosha e fermerit	Nën 40 vjet	5	
		40 e më shumë vjet	3	
7.	Gjinia (e aplikuesit të regjistruar në regjistrin e fermerëve)	Femër	5	
		Mashkull	3	
Total				100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve në fund të listës, atëherë parësi kanë projektet që kanë numër më të vogël të kafshëve. Në qoftë se edhe numri i kafshëve është i njëjtë, atëherë përparësi ka ai që ka aplikuar më herët.

8. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € bëhen nëpërmjet bankës, ndërsa nën 500 € duhet të merret fatura dhe kupon fiskal.

9. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	300,000 €	
Outputi	Numri. i fermave të mbështetura	9
	Vëllimi i përgjithshëm i investimit (në €)	444,000
Rezultati	Numri i stallave të reja	8
	Numri i fermave me kualitet të përmirësuar të veve	7
	Numri i fermave me deponi të reja të plehut për mbrojtje të mjedisit	6
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar (ekuivalente me vende të punës me orar të plotë)	

10. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

300,000 €.

■ Nënmasa

Prodhimet e mishit të viçit dhe broilerëve

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Aktualisht industria e mishit të viçit është nënprodhim i industrisë së qumështit. Vetëm një numër i fermave janë përqendruar në majmëri me një numër relativisht të vogël të krerëve. Mishi i kuq e sidomos ai i viçit është prodhimi i popullarizuar dhe ofron mundësi për zëvendësimin e importit. Prodhimi i mishit karakterizohet me therjen e hershme të krerëve, shumica e viçave të therur janë më të ri se 8 muaj, prandaj ekonomikisht nuk është shumë efikase.

Prodhimi e mishit të pulës është aktualisht i bazuar në pula që janë të destinuara për prodhimin e vezëve dhe pulat në ekonomitë familjare. Vetëm disa prodhues vendor janë të specializuar në prodhimin e mishit nga broilerët. Prodhimi i mishit nga broilerët ka potencial për zhvillim.

Kërkesa aktuale e vendit vlerësohet të jetë 30,000 ton/në vit ose 18,000,000 broilerë. Megjithatë shumica e fermave janë të vogla me numër të vogël të pulave, stallat nuk janë të përshtatshme për prodhimtari, teknologjia është e vjetruar dhe fermat kanë ndikim negativ në mjedis.

Të gjithë këta faktorë janë të rëndësishëm dhe duhet të përmirësohen në mënyrë që të kenë prodhim të mirë e cilësor.

2. Objektivat specifike të nënmasës

- Ndërtimi i stallës së re;
- Modernizimi dhe përmirësimi i standardeve relevante të fermës:
 - higjiena dhe siguria,
 - kualiteti i mishit,
 - shëndeti i kafshëve,
 - mirëqenia e kafshëve;
- Ndërtimi i deponive të plehut.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit për trashjen e viçave

- a) Të jenë të regjistruar si fermerë në Sektorin për Identifikimin dhe Regjistrimin e kafshëve (I&R) në Agjensinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);
- b) Aplikuesit duhet të kenë kafshë me matrikuj të Republikës së Kosovës (me përjashtim të atyre të importuara nga BE që mund të mbajnë matrikujt me të cilët janë importuar) dhe të posedojnë listën e bagëtisë për çdo krerë të regjistruar, të lëshuar nga AUV;
- c) Aplikuesit duhet të kenë së paku 15 krerë (viça);
- ç) Aplikuesit duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku 0,3 ha/krerë, tokë bujqësore (ara, livadhe dhe kullota). Toka mund të jetë në pronësi ose e marrë me qira për së paku tri vjet.

4. Investimet e pranueshme për trashjen e viçave

4.1. Ndërtimi i stallës së re për viça me mbajtje të kafshëve sipas tipit të lidhur, me dimension se paku 20,40m x 10,40m me infrastrukturë të brendshme si më poshtë:

- Grazhdet;
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe ujëpirëset;
- Vendqëndrimet për kafshë;
- Dyert ballore- copë 2;
- Dritaret me pozicion horizontal;
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës;
- Sistemi i ventilimit;
- Depo e ushqimit të koncentruar.

Ose

4.2. Ndërtimi i stallës së re, me dimension se paku 20,40m x 10,40m, me mbajtje të kafshëve sipas tipit të lirë, me këtë infrastrukturë të brendshme:

- Grazhdet;
- Shtretërit;
- Kanali për largimin e plehut dhe sistemi për largimin e plehut;
- Dyert ballore- copë 2;
- Dritaret me pozicion horizontal;
- Instalimi i rrjetit elektrik brenda fermës;
- Sistemi i ventilimit.

4.3 Përmirësimi i infrastrukturës përcjellëse në fermë:

- Deponi e plehut të stallës (i lëngët dhe i ngurtë), në përputhje me numrin e krerëve;
- Deponi për silazh (sistemi horizontal) në përputhje me numrin e krerëve;
- Deponi për ushqim voluminoz (hangarë) në përputhje me numrin e krerëve;
- Peshore për matjen e kafshëve të gjalla.

5. Investimet e pranueshme për broilerë

5.1. Ndërtimi i stallës së re me kapacitet prej së paku 3.600 broiler me sipërfaqe prej se paku 270 m² me infrastrukturë:

- Sistemet e ventilimit;
- Sistemet e ujit brenda në fermë;
- Sistemi i ushqimit;
- Sistemi i ngrohjes;
- Sistemi i ndriçimit.

6. Dokumentacioni specifik i nevojshëm

6.1. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikuesit për trashjen e viçave:

- a) Dëshmia kadastrale e tokës bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) në pronësi ose një kopje e kontratës për qiramarrje të tokës bujqësore për të paktën tre vjet pas aplikimit;
- b) Kopje e kontratës me një thertore e cila është licencuar nga AUV;
- c) Kopjen e listës së verifikimit të bagëtive të lëshuar nga Sektori për Identifikimin dhe Regjistrimin në AUV për të gjithë viçat për majmëri.

Aplikuesit e përzgjedhur po ashtu duhet të dorëzojnë edhe:

- a) Një leje ndërtimi e lëshuar nga organi kompetent komunal;
- b) Pëlqimi i komunitetit në mjedisin ku ndërtimi i stallës për viça është planifikuar;

- c) Një deklaratë mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor për fermerët që kanë aplikuar për fermë me mbi 100 viça.

Aplikuesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

- Një leje ndërtimi e lëshuar nga organi kompetent komunal;
- Pëlqimi i komunitetit në mjedisin ku ndërtimi i stallës është planifikuar;
- Dëshmi mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor (nga MMPH) vetëm për ata që aplikojnë për ferma me mbi 10.000 zogj.

7. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

7.1. Për trashjen e viçave:

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës së viçave sipas pikëve 4.1 ose 4.2 është: 25.000 €;
- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme sipas pikës 4.3 është: 15.000€.

7.2. Për rritjen e broilerëve

7.2.1. Ndërtimi fermës për broilerë (sipas pikës 5.1.):

- Kufiri më i lartë i shpenzimeve të pranueshme për ndërtimin e stallës për broilerë është: 25.000 €.
- Stalla e kompletuar për broiler duhet të ketë kapacitet për së paku 3.600 zogj;
- Fermerët mund të ndërtojnë edhe stalla më të mëdha, por MBPZHR merr përsipër 65 % të shpenzimeve të pranueshme deri në 25,000 €.

8. Kriteret e përzgjedhjes

8.1. Për trashjen e viçave

Nr.	Lloji i kriterit		Kategoria e kriterit	Pikë
1	Projekti që përmban	Ndërtimi i stallës së re	Po	40
			Jo	10
		Deponia e plehut	Po	30
			Jo	10
2	Nr. i viçave në momentin e aplikimit		15-50 krerë	10
			Më shumë se 50 krerë	5
3	Pronësia e tokës (pasi që secili aplikues duhet të ketë 0,30 ha tokë për kokë viçi		Pronë e aplikuesit 50% e më shumë	10
			Mbi 50% e marrë me qira	5
4	Mosha e fermerit		Nën 40 vjet	5
			40 ose më shumë vjet	3
5	Gjinia (e aplikuesit të regjistruar në regjistrin e fermës)		Femër	5
			Mashkull	3
Totali				100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve në fund të listës, atëherë parësi kanë projektet që kanë numër më të vogël të kafshëve. Në qoftë se edhe numri i kafshëve është i njëjtë, atëherë përparësi ka ai që ka aplikuar më herët.

8.2. Për rritjen e broilerëve

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë
1.	Madhësia e fermës	3,600-10,000	65
		10,001-100,000	50
2.	Kontratë për shitjen e prodhimit	Ekziston	15
		Nuk ekziston	10
3.	Mosha e fermerit	Nën 40 vjet	10
		40 ose më shumë vjet	8
4.	Gjinia (e aplikuesit të regjistruar në regjistrin e fermës)	Femër	10
		Mashkull	8
	Totali		100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve në fund të listës, atëherë parësi kanë projektet që kanë numër më të vogël të kafshëve. Në qoftë se edhe numri i kafshëve është i njëjtë, atëherë përparësi ka ai që ka aplikuar më herët.

9. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

10. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	700.000 janë të ndara për viça dhe broilerë, siç vijon: - 350.000 për viça; - 350.000 për zogj.	
Outputi	Nr. i fermave të mbështetura	34
	a) viçat	16
	b) broilerët	18
	Vëllimi i përgjithshëm i investimit (në €)	1,035,000
	a) viçat	517,500
	b) broilerët	517,500
Rezultati	Numri i fermave me stallë të re për	32
	- viça	15
	- broilerë	17
	Numri i fermave me deponi të plehut	26
	a) viça	12
	b) broilerë	14
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhim bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar (ekuivalente me vende të punës me orar të plotë)	

11. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmasë janë:

700.000 € të ndara si më poshtë:

- 350.000 € për trashjen e viçave;
- 350.000 € për rritjen e broilerëve.

■ Nënmasa

Ekonomit bujqësore prodhuese të mjaltit

1 Arsyeshmëria e nënmasës

Sektori i prodhimit të mjaltit në Kosovë është shumë i rëndësishëm. Aktualisht janë rreth 6500 bletarë me 70500 koshere. Bletaria dhe prodhimi i mjaltit janë shtyllë e rëndësishme për sigurimin e të ardhurave të popullsisë në zonat rurale. Mjalti është i cilësisë së mirë dhe shitet kryesisht si prodhim natyral.

Vetëm dy bletarë kanë teknologji modernë për përpunimin e nënprodhimeve të mjaltit. Mjalti dhe prodhimet e tij konsiderohet se kanë potencial për eksportim në tregun e BE-së, sidomos pas certifikimit të mjaltit si prodhim ekologjik.

2. Objektivat specifike

- Shtimit të numrit të koshereve;
- Modernizimi dhe përmirësimi i pajisjeve për prodhimin e mjaltit;
- Krijta e sasisë së mjaltit të certifikuar si mjaltë natyral – ekologjik.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

Aplikuesit duhet të kenë së paku:

- 50 koshere,
- jo më shumë se 500.

4. Investimet e pranueshme për prodhuesit e mjaltit

1. Investimet primare:

- 1.1 Koshere me dysheme antivaro, 50 € për koshere, jo me shumë se 2500 € për aplikues;
- 1.2 Vija e vjeljes së mjaltit (materiali INOX- e qëndrueshëm ndaj thartirave):
 - 1.2.1 Centrifuga elektrike kashtore,
 - 1.2.2 Vaskë (korite) për kornizat e ç'vulosura,
 - 1.2.3 Vaskë (tepsi) për ç'vulosje për korniza,
 - 1.2.4 Zhvulosës elektrike për korniza;
- 1.3 Shkrirëse e dyllit për hoje (elektrike ose me gas);
- 1.4 Rimorkio speciale për transportin e koshereve;
- 1.5 Rrethoja e bletnajës (5 € për koshere), por më se shumti 500 €.

2. Paketuese

- 2.1 Paketuese e vogël ose
- 2.2 Paketuese e madhe;
- 2.3 Ndërtimi i dhomës për nxjerrjen e mjaltit (jo më shumë se 5,000 €).

5. Dokumentet specifike të nevojshme

- Dëshmi që vërteton anëtarësinë në Shoqatën e Bletarëve;

- Dëshmi për numrin e koshereve nga Shoqata e Bletarëve;
- Certifikatën për ndjekjen e trajnimeve profesionale për bletari;
- Aplikuesit e përzgjedhur duhet të sjellin edhe lejen e ndërtimit të lëshuar nga organi kompetent komunal.

6. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

- Përkrahja financiare e MBPZHR-së është 65% e investimeve të pranueshme.
- Kufiri i poshtëm i investimit është 2.000 € dhe kufiri i epërm 15 000€.
- Çdo investim mbi kufirin e epërm konsiderohet shpenzim i papranueshëm

7. Kriteret e përzgjedhjes

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë	
1.	Projekti që përmban	Koshere me dysHEME antivaro	Po	20
			Jo	5
		Ndërtimi dhomës për nxjerrjen e mjaltit	Po	15
			Jo	5
		Vija e vjeljes së mjaltit	Po	15
			Jo	1
		Centrifuga elektrike kasetore	Po	10
			Jo	5
		Shkrirëse e dyllit për hoje	Po	5
			Jo	1
		Paketuese	Po	5
			Jo	1
	Rimorkio speciale për transportin e koshereve	Po	5	
		Jo	2	
2.	Numri i koshereve	50-300 koshereve	5	
		300-500 koshereve	1	
3.	Prodhues i certifikuar si prodhues organik	Po	5	
		Jo	2	
4.	Dëshmi për pjesëmarrje në trajnime profesionale	Po	5	
		Jo	2	
5.	Mosha e fermerit	Nën 40 vjet	5	
		40 e më shumë vjet	3	
6.	Gjinia (e aplikuesit të regjistruar në regjistrin e fermerëve)	Femër	5	
		Mashkull	3	
Total			100	

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve në fund të listës atëherë parësi kanë projektet që kanë numër më të vogël të koshereve. Në qoftë se edhe numri i koshereve është i njëjtë, atëherë përparësi ka ai që ka aplikuar më herët.

8. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.
Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.
Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet bankës.
Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kupon i fiskal.

9. Treguesit e monitorimi

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	250,000 €	
Outputi	Nr. I fermave të mbështetura	24
	Vëllimi i përgjithshëm i investimit (në €)	370,000
Rezultati	Numri i koshereve të blera si rezultat i investimit	990
	Dhoma të reja të ndërtuar a/	17
	Numri i bletarëve me pajisje të reja për përmirësimin e kualitetit të mjaltit dhe plotësimin e standardeve	19
	Numri i bletarëve me rimorkio të reja për transportin e koshereve	16
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar (ekuivalente me vende të punës me orar të plotë)	

10. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

250,000 €.

■ Nënmasa

Sektori i frutave

1. Arsyeshmeria e nënmasës

Parësi e MBPZHR-së është që të rrisë sipërfaqet për prodhimtarinë e mollës, si dhe të rrisë efikasitetin e prodhimit në pemishtet ekzistuese. Investimet përfshijnë përkrahjen në ngritjen e pemishteve të reja dhe modernizimin e infrastrukturës në pemishtet ekzistuese.

2. Objektivat specifike

- Rritja sipërfaqeve të fermave me pemishte;
- Rritja e sipërfaqeve me molla, dredhëza, manaferra dhe mjedra;
- Përmirësimi i cilësisë dhe shumëllojshmërisë së pemishteve.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

- Fermerët duhet të paraqesin dëshmi për posedimin e tokës bujqësore (toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim);
- Në rastet e ngritjes së pemishteve të mollës në tokë të marrë me qira - e drejta e shfrytëzimit të tokës duhet të dëshmohet për se paku 15 vjet;
- Në rastet e shfrytëzimit të tokës së marre me qira duhet të prezantohet miratimi me shkrim i pronarit të tokës për ngritjen e pemishtes;
- Për pemishte të mollës: fermerët duhet të kenë se paku 0,50 ha tokë;
- Për pemishte me mollë, parcelat e pranueshme duhet të jenë 0,50 ha tokë (në një parcele);
- Për dredhëza: fermerët duhet të ngrisin se paku 0,20 ha pemishte;
- Për mjedra dhe manaferra: fermerët duhet të ngrisin se paku 0,10 ha pemishte në një parcele.

Në rastin e dredhëzës/mjedrës dhe manaferrës, infrastruktura komplete është e domosdoshme.

4. Investimet e pranueshme

4.1 Për ngritjen e pemishteve të reja me mollë:

- Ngritja e pemishteve të reja me mollë për prodhim intensiv (shpenzimet e fidanëve, përgatitja e tokës për mbjellje, shpenzimet e mbjelljes etj.);
- Investimet në infrastrukture:
 - sistemi i ujitjes pikë - pikë,
 - sistemi i mbajtjes,
 - rrethoja,
 - sistemi i mbrojtjes nga breshëri (rrjeta), deri në 1 ha.

4.2 Investimet në infrastrukturën e pemishteve ekzistuese të mollës,

- jo me të vjetra se tri vjet:
- sistemi i ujitjes pikë - pikë,

- sistemi i mbajtjes,
- rrethoja,
- sistemi i mbrojtjes nga breshëri (rrjeta), por vetëm deri në 1 ha.

4.3 Investimet për krijimin e pemishteve të reja me pemë të imta (dredhëza, manaferra dhe mjedra), si vijojnë:

- a) Për dredhëza: fidanët, sistemi i ujitjes pikë - pikë e folje të zezë;
- b) Për manaferra dhe mjedra: fidanët, sistemi i ujitjes pikë - pikë.

Investimet për ngritjen e pemishtes së dredhëzës, manaferrës dhe mjedrës duhet të përfshijnë infrastrukturën complete, siç përmendet më lart.

5. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nënmasën

- a) Kopjen e fletës poseduese për sipërfaqen e tokës;
- b) Kopjen e planit të lëshuar nga kadastra (për parcelën ku bëhet investimi, ngritjen e pemishtes);
- c) Kopjen e diplomës së fakultetit ose e shkollës së mesme (nëse e kanë);

6. Përfituesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente

- a) Materiali për fidane i importuar duhet të posedojë dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare);
- b) Përfituesit që mbjellin pemishte të reja, për materialin për fidanë të mbjella duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore.

7. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

Për ngritjen e pemishteve të reja të mollës me infrastrukturë complete (pa sistemin e mbrojtjes kundër breshrit) :

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është: 120 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha është: 60.000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike, për shpenzimet e pranueshme, është: 65 %, kurse maksimumi i mbështetjes publike është: 39,000 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

Investimet për infrastrukturën e pemishteve (përveç sistemit për mbrojtjen nga breshëri):

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është: 60 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha është: 30.000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65%, kurse maksimumi i mbështetjes publike është: 19,500 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

Çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

Për investimet në sistemin e mbrojtjes nga breshëri:

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është: 120 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ha është: 12.000 €;

- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, kurse maksimumi i mbështetjes publike është: 7.800 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

Investimet për krijimin e plantacioneve të dredhëzës, mjedrës dhe manaferrës me infrastrukturë complete.

A. Për dredhëza

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ar është: 150 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm që i referohet deri në 2 ha, prandaj shpenzimet maksimale të pranueshme janë: 30,000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, kurse maksimumi i mbështetjes publike është: 19,500 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

B. Për mjedra dhe manaferra

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ar është: 150 €;
- Investimi maksimal për 1 ha është: 15,000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, kurse maksimumi i mbështetjes publike është: 9,750 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

8. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela 1. Për krijimin e pemishteve të reja me mollë

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoritë e kriterëve	Pikë
1.	Sipërfaqet që do të mbillen me mollë (ha)	4.51 - 5.00	30
		4.01 - 4.50	28
		3.51 - 4.00	26
		3.01 - 3.50	24
		1.01 - 3.00	22
		0.50 - 1.00	20
2.	Ngritja e pemishtes	Ngritja e sipërfaqeve të reja me infrastrukturë complete	25
		Vetëm infrastruktura	20
3.	Struktura varietore në parcelë	Pemishte me mbi 4 varietete	15
		Pemishte me 4 varietete ose me pak	10
4.	Niveli i përgatitjes arsimore	Përgatitja e nivelit universitar: agronom i përgjithshëm ose PV	10
		Përgatitja e nivelit të mesëm: shkolla e mesme e bujqësisë	8
6.	Mosha	Deri në 40 vjet	10
		40 dhe më shumë	8
7.	Gjinia (sipas regjistrimit në regjistrin e fermës)	Femër	10
		Mashkull	8
	Totali		100

Tabela 2. Kriteret e përzgjedhjes për infrastrukturën e pemishteve

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoritë e kriterëve	Pikë.
1.	Sipërfaqja për të cilën do të vendoset infrastruktura (ha)	4.51 - 5.00	30
		4.01 - 4.50	28
		3.51 - 4.00	26
		3.01 - 3.50	24
		1.01 - 3.00	22
		0.50 - 1.00	20
2.	Struktura varietore në parcele	Pemishte me se paku 5 varietete	35
		Pemishte me 4 varietete ose me pak	20
3.	Niveli i përgatitjes arsimore	Përgatitja e nivelit universitar: agronom i përgjithshëm ose PV	15
		Përgatitja e nivelit të mesëm: shkolla e mesme e bujqësisë	12
4.	Mosha	Deri në 40 vjet	10
		40 dhe me shumë	
5.	Gjinia (sipas regjistrimit në regjistrin e fermës)	Femër	10
		Mashkull	8
	Totali		100

Tabela 3. Kriteret e përzgjedhjes për ngritjen e pemishtes për dredhëza, mjedra dhe manaferra

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoritë e kriterëve	Pikë
1.	Sipërfaqja që do të mbillet me dredhëza (ha)	1.81 - 2.00	60
		1.61 - 1.80	55
		1.41 - 1.60	50
		1.21 - 1.40	45
		1.01 - 1.20	40
		0.81 - 1.00	35
		0.61 - 0.80	30
		0.41 - 0.60	25
		0.20 - 0.40	20
2.	Sipërfaqja që do të mbillet me mjedra ose manaferra (ha)	0.91 - 1.00	60
		0.81 - 0.90	55
		0.71 - 0.80	50
		0.61 - 0.70	45
		0.51 - 0.60	40
		0.41 - 0.51	35
		0.31 - 0.40	30
		0.21 - 0.30	25
		0.10 - 0.20	20
3.	Niveli i përgatitjes arsimore	Përgatitja e nivelit universitar: agronom i përgjithshëm ose PV	20
		Përgatitja e nivelit të mesëm: shkolla e mesme e bujqësisë	18
4.	Gjinia	Deri në 40 vjet	10
		40 dhe me shumë	8
5.	Mosha	Femër	10
		Mashkull	8
	Totali		100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve të fundit, atëherë përparësi kanë projektet që kanë sipërfaqe më të madhe. Nëse edhe sipërfaqet për nga madhësia janë të njëjta, atëherë do të aplikohet parimi: ‘kush aplikon i pari, shërbehet i pari’.

9. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 60 ditësh nga data e aprovimit të projektit, përveç për ngritjen e pemishteve të mollës investimi mund të pranohet deri me 15 nëntor.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat me të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

10. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	Për 1.200.000 €, siç vijon: 1. Ngritja e sipërfaqeve të reja për pemishtet e mollëve: 700.000 € 2. Mbështetje për infrastrukturën e pemishteve të mollës 200.000 € 3. Ngritja e sipërfaqeve të reja me dredhëza, mjedra e manaferra 300.000 €	
Ouptuti	Nr. i fermave të mbështetura, është siç vijon	54
	1. Numri i pemishteve të reja të mollës	22
	2. Numri i fermerëve të mbështetur për infrastrukturën e pemishteve të mollës	9
	3. Ngritja e sipërfaq. të reja me dredhëza, mjedra dhe manaferra	32
	Vëllimi i gjithëmbarsëm i investimit (në €) është siç vijon:	1,775,000
	1. Ngritja e sipërfaqeve të reja për pemishtet e mollëve	1,035,000
	2. Mbështetje për infrastrukturën e pemishteve të mollës	296,000
	3. Ngritja e sipërfaq. të reja me dredhëza, mjedra dhe manaferra	444,000
Rezultati	Pemishte të reja të mollës (ha)	83
	Pemishtet ekzistuese të mollëve me infrastrukture të përmirësuar (ha)	36
	Fusha të reja për kultivimin e dredhëzave, mjedrës dhe manaferrave (ha)	21
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve ekuivalente të reja të punës që janë krijuar	

11. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

1. Ngritja e sipërfaqeve të reja për pemishtet e mollëve: 700.000 €
2. Mbështetje për infrastrukturën e pemishteve mollë: 200.000 €
3. Ngritja e sipërfaqeve të reja me dredhëza, mjedra dhe manaferra: 300.000 €

Totali i mbështetjes/përkrahjes publike: 1.200.000 €

■ Nënmasa

Sektori i vreshtave për rrush të tryezës

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Kosova ka kushte agro-klimatike mjaft të mira për zhvillimin sektorit të vreshtave. Duke u bazuar në potencialin natyral ekzistues kjo mbështetje ka për qëllim që vendit t'ia kthejë pozitën në tregun vendor dhe ndërkombëtar për eksport të rrushit të tryezës.

Investimet kanë për qëllim ngritjen e vreshtave të reja të rrushit të tryezës, si dhe modernizimin e infrastrukturës në mënyrë që të përmirësojë efikasitetin nëpër ferma.

2. Objektivat specifike

- Rritja sipërfaqeve të fermave me vreshta të reja me rrush të tryezës;
- Përmirësimi i strukturës varietore të rrushit të tryezës në Kosovë;
- Përmirësim/modernizimi i sistemeve mbështetëse për vreshta për rrush tryeze.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

- Të paraqesin dëshmi për posedimin e tokës bujqësore; toka mund të jetë në pronësi ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 15 vjet;
- Në rastet e shfrytëzimit të tokës së marrë me qira duhet të prezantohet miratimi me shkrim i pronarit të tokës për ngritjen e vreshtit;
- Madhësia minimale e parcelës së pranueshme për ngritjen e plantacioneve të vreshtave/investimet në plantacionet ekzistuese janë 0.20 ha;
- Madhësia minimale për ngritjen e plantacioneve të vreshtave/investimet në plantacionet ekzistuese janë së paku 0.50 ha

4. Investimet e pranueshme

4.1 Investimet e pranueshme për ngritjen e plantacioneve të reja:

- Ngritja e vreshtave të reja të rrushit të tryezës (p.sh., shpenzimi me fidanë - material i cili përmbush të gjitha standardet të parapara sipas Ligjit për materialin për fidanë 2004/13 of 28.05.2004;
- shpenzimet për përgatitjen e tokës, sistemi i mbajtjes standard/konvencional ose sistemi mbështetës i llojit T etj.).
- Sistemi i ujitjes pikë-pikë (në qoftë se ka burim uji).

4.2 Investimet në infrastrukturë për vreshtat ekzistuese jo më të vjetra se 2 vjet:

- Sistemi mbështetës i llojit T dhe ai standard/konvencional;
- Sistemi i ujitjes pikë-pikë (në qoftë se ka burim uji).

5. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për këtë nënmase

- Numrin identifikues të fermerit (vreshtar), i cili nxirret në Entin e Vreshtarisë dhe të Verërave;
- Dëshmitë kadastrale (letrën poseduese me kopjen e planit) për sipërfaqen e tokës bujqësore (duke përjashtuar të dhënat kadastrale për pyje, oborre etj., që nuk janë tokë bujqësore);
- Dëshmi për pronësinë e tokës ose kopjen e kontratës që dëshmon përkatësinë e tokës bujqësore se paku për 15 vite pas aplikimit.

6. Përfituesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

- Materiali për fidanë i importuar duhet të posedoj dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare)
- Përfituesit që mbjellin vreshta të reja, për materialin e mbjellë fidanor duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore.

7. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

Shpenzimet maksimale të pranueshme në rast të ngritjes së vreshtave dhe rrushit të tryezës për 1 ari është siç vijon:

- Mbjellja e sipërfaqeve të reja – 80 €;
- Sistemi mbështetës – në rast të sistemit konvencional – 40 € në rast të T sistemit - 80 €;
- Sistemet e ujitjes – 14 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është: 174 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha, është: 87,000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme është): 65 %, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është: 56,550 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

A. Shpenzimet maksimale të pranueshme në infrastrukturën ekzistuese të vreshtave të rrushit të tryezës për 1 ar janë, siç vijon:

- Sistemet e mbështetjes – në rast të sistemeve konvencionale - 40 €, në rast të sistemit T - 80 €;
- Sistemet e ujitjes – 14 €;
- Investimi maksimal për 1 ar është 94 €;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha, është 47,000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme): 65 %, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 30,550 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

Çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

8. Kriteret e përzgjedhjes

Nr	Lloji i kriterit	Kategoritë e kriterëve	Pikë
1.	Sipërfaqja (madhësia) e vreshtave në (ha)	4.51 - 5.00	40
		4.01 - 4.50	37
		3.51 - 4.00	34
		3.01 - 3.50	31
		2.51 - 3.00	28
		2.01 - 2.50	25
		1.51 - 2.00	22
		0.50 - 1.00	19
2.	Strukt. variatore në parcelë (numri i variateteve për tërë sipërfaqen e parcelës)	1 variatet për 1 ha	10
		Më shumë se 1 variatet për ha	8
3.	Sistemi mbështetës	Lloji T	20

		Standard/Konvensional	10
4.	Niveli i përgatitjes arsimore	Përgatitja e nivelit universitar: agronom i përgjithshëm ose PV	10
		Përgatitja e nivelit të mesëm: shkolla e mesme e bujqësisë	8
5.	Gjinia	Deri në 40 vjet	10
		Më shumë se 40 vjet	8
6.	Mosha	Femër	10
		Mashkull	8
Totali			100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve të fundit, atëherë parësi kanë projektet që kanë sipërfaqe më të madhe. Nëse edhe sipërfaqet për nga madhësia janë të njëjta, atëherë do të aplikohet parimi: ‘kush aplikon i pari, shërbehet i pari’.

9. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Investimi mund të pranohet deri më 15 nëntor.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

10. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	200.000 €	
Outputi	Nr i fermave të përkrahura.	7
	Vëllimi i gjithëmbarshtëm i investimit (€)	296,000
Rezultati	Vreshtat e reja për rrush të tryezës me strukture të ndryshme të përmirësuar dhe sistemin mbështetës të përmirësuar (ha)	9
	Vreshtat ekzistuese me infrastrukture të përmirësuar	17
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve ekuivalente të reja të punës që janë krijuar	

11. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

200,000 €

■ Nënmasa

Sektori i perimeve

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Prodhimtaria e perimeve është një prej degëve me intensive të prodhimitarisë bimore. Prandaj në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti në ferma, janë të nevojshme investime për ndërtimin e serrave të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, si dhe futjen e teknologjive të reja modernë për kultivimin e perimeve në fusha të hapura.

Aktualisht ka hapësirë për investime në këtë sektor: si në serra dhe në fushë të hapur. Megjithatë, edhe përkundër interesit të shprehur, Kosova është ende shumë larg plotësimit të kërkesave për konsum vendor, veçanërisht për të zgjatur sezonin e prodhimit.

2. Objektivat specifike

- Rritja sipërfaqeve me serra për kultivimin e perimeve;
- Mbështetje për teknologji të reja për kultivimin e perimeve në fushat e hapura për rritjen e efikasitetit të prodhimitarisë;
- Sigurimi i furnizimit të tregut vendor, në një periudhë më të gjatë kohore, me perime të freskëta.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

3.1 Në rast të serrave për prodhimin e perimeve:

- Dëshmi për posedimin e tokës bujqësore; toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 5 vjet;
- Investimi në ngritjen/zgjerimin (konstruktimin) e serrave të reja të tipit "Tunnel" ose bllok nga polieteni me sipërfaqe minimale prej 500 m²;
- Investimi në ngritjen/zgjerimin (konstruktimin) e serrave të reja të tipit "Bllok" nga polieteni me sipërfaqe minimale prej 500 m².

3.2 Në rast të fushave të hapura për prodhimin e perimeve:

- Dëshmi për posedimin e tokës bujqësore, toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 1 vjet,
- Investimet duhet të bëhen në se paku 0,50 ha;
- Përfituesit duhet të kultivojnë në 3 vjetet e ardhshme vetëm perimet e cekura në sipërfaqet e përkrahura, trangujt për përpunim, shalqi, pjepër, domate, specia apo fasule si monokulturë me mbështetëse dhe rrjeta

4. Investimet e pranueshme

- Për ngritjen e serrave të reja për prodhimin e perimeve;
- Konstruktimi i serrave të reja dhe rritja e kapaciteteve prodhuese me serrat e reja;
- Llojet e përkrahura të serrave:
 - Serrat e llojit "Tunnel" nga polieteni,
 - Serrat e llojit "Bllok" nga polieteni 500 – 2.000 m² ose 2 x 1.000 m².
- Nëse serrat janë me të avancuara se specifikimet e dhëna nga MBPZHR ato duhet të pranohen;
- Sistemi i ujitjes pikë - pikë me pajisje për plehra kristalore.

Për infrastrukturën e fushave të hapura me perime

- Sistemi i ujitjes pikë -pikë me pajisje për plehra kristalore;
- Folja plastike për mulqerim dhe rrjeta plastike për sistemin mbështetës. Kolonat mbështetëse, duhet të jenë vetëm për domate, tranguj dhe fasule,
- Folja plastike për mini tunele (shalqiri dhe pjepri).

5. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nënmasën:

- Dëshmi mbi pronën (të gjitha), në raste të serrave të dëshmojë pronësinë e tokës për se paku 5 vite (pronë vetanake ose me qira);
- Kopje e planit (për investimin e bërë, ngritje serrës);
- Kopjen e certifikatës për trajnim të veçante relevant ose dëshmi të shkruar që do të marrin pjesë në trajnimin përkatës brenda afatit për kompletimin e projektit.

6. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

6.1 Për krijimin e serrave për perime

- Shpenzimet e pranueshme për 1 ari të serrës se re: 2,000 € (por jo me pak se 5 ari);
- Sipërfaqja maksimale e pranueshme për serrat e reja: 2,000 m²;
- Shpenzimet maksimale të pranueshme: 40,000 €;
- Intensiteti i ndihmës (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %;
- Maksimumi i mbështetjes publike është: 26,000 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

6.2 Investimet për infrastrukturën e fushave të hapura me perime

Speci:

- Investim i pranueshëm për 1 ar është: 15 €;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë: 4,500 €;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, prandaj ndihma publike maksimale është: 2,950 €.

Trangulli për përpunim:

- Investim i pranueshëm për 1 ar është: 35 €;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë: 10,500 €;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %, prandaj ndihma publike maksimale është: 6,825 €.

Shalqiri dhe pjepri:

- Investim i pranueshëm për 1 ari është: 20 €;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë: 6,000 €;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %, prandaj ndihma publike maksimale është: 3,900€.

Domate:

- Investim i pranueshëm për 1 ari është: 20 €;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë: 6,000 €;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, prandaj ndihma publike maksimale është: 3,900 €.

Fasule si monokulturë

- Investim i pranueshëm për 1 ari është: 35 €;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë: 10,500 €;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është: 65 %, prandaj ndihma publike maksimale është: 6,825 €.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

Çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

7. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela 1. Kriteret vlerësimit të pikëve për ngritjen / zgjerimin e serrave të reja

Nr.	Lloji i kriterëve	Kategoritë e kriterëve	Pikë
1.	E tere sipërfaqja e serrave të reja (m ²)	1.501- 2.000	20
		1.001 - 1.500	15
		500 - 1.000	10
2.	Pronësia e tokës (pronësi ose me qira)	Më shumë se 50% është pronë vetanake	10
		50% ose me pak është pronë vetanake	5
3.	Lloji i serrave	Serra e tipit "Blok"	30
		Serra e tipit "Tunnel"	20
4.	Niveli i përgatitjes arsimore	Përgatitja e nivelit universitar: agronom	20
		Përgatitja e nivelit të mesëm: shkolla e mesme e bujqësisë	15
5.	Gjinia	Deri në 40 vjet	10
		Më shumë se 40 vjet	8
6.	Mosha	Femër	10
		Mashkull	8
Totali			100

Tabela 2. Kriteret e vlerësimit të pikëve për infrastrukturën e fushave të hapura me perime

Nr.	Lloji i kriterëve	Kategoritë e kriterëve	Pikë
1	Sipërfaqja me perime në fusha të hapura (ha)	2.51 - 3.00	50
		2.01 - 2.50	45
		1.51 - 2.00	40
		1.01 - 1.50	35
		0.5 - 1.00	30
2	Fermeri posedon më shumë se 3 ha perime në fushë të hapur	Po	20
		Jo	10
4.	Niveli i përgatitjes arsimore.	Përgatitja e nivelit universitar: agronom	10
		Përgatitja e nivelit të	8

		mesëm: shkolla e mesme e Bujqësisë	
5.	Gjinia	Deri në 40 vjet	10
		Më shumë se 40 vjet	8
6.	Mosha	Femër	10
		Mashkull	8
Totali			100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë të pikëve të projekteve të fundit, atëherë përparësi kanë projektet që kanë sipërfaqe më të madhe. Nëse edhe sipërfaqet për nga madhësia janë të njëjta, atëherë do të aplikohet parimi: 'kush aplikon i pari, shërbehet i pari'.

8. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 90 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat me të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kupon fiskal.

9. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	Fushat e hapura: 400.000 € Serrat: 1.000.000 €	
Outputi	Nr. i fermave të përkrahura	167
	Fushat e hapura:	112
	Serrat:	55
	Vëllimi i gjithëmbarshëm i investimit (në €)	2,070,000
	Fushat e hapura	591,000
	Serrat:	1,479,000
Rezultati	Sipërfaqet e reja të serrave(ha)	254
	Fusha të hapura me teknologji të përmirësuara të prodhimit në (m ²)	79,000
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar, ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	

10. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

- Fushat e hapura: 400.000 €
- Serrat: 1.000.000 €

■ Nënmasa

Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese

Me këtë masë përfshihen vetëm këto prodhime jodrusore të malit: frutat, kërpudhat dhe bimët aromatike dhe mjekësore

1. Arsyeshmëria e nënmasës

Argumentet kryesore për të mbështetur financiarisht pikat grumbulluese për frutat e malit, kërpudhat, bimët aromatike dhe mjekësore janë:

- prania e tyre e mjaftueshme në vendin tonë;
- fuqia punëtore jo e shtrenjtë dhe e pranishme;
- tregjet e siguruara në vendet perëndimore;
- mundësia për të rritur vlerën e prodhimeve dhe për të zvogëluar humbjet në prodhim.

2. Objektivat e specifike

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të vendit;
- Krijimi dhe sigurimi i vendeve të punës, sidomos në zonat e largëta rurale;
- Rritja e të ardhurave dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat e largëta rurale;
- Ruajtja nga humbja/prishja e prodhimeve të grumbulluara - shtimi i kapacitetit grumbullues.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

- Aplikuesit e përzgjedhur duhet të marrin lejen përkatëse për të zhvilluar këtë aktivitet nga Departamenti i Pylltarisë në MBPZHR.

4. Investimet e pranueshme

- Tharëset;
- Frigoriferët;
- Makina për pastrim;
- Makina për prerje (grirje).

5. Dokumentacionet e nevojshme specifike

- Dëshmia e sasisë së grumbulluar në dy vitet e fundit;
- Fleta poseduese e pronës ku do të bëhet investimi.

6. Niveli i mbështetje dhe intensiteti i ndihmës publike

Deri në 30,000 € për projekt.

7. Kriteret e përzgjedhjes

Tabela 1

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë
1	Përvoja në grumbullim (të dëshmohet me fatura të dorëzimit të prodhimeve)	Mbi 1 vit	30
		2 vite e më shumë, më pak se 3 vite	40
		3 vite e më shumë	50
2	Sasia e grumbulluar në dy vitet e fundit (të dëshmohet me fatura të dorëzimit të prodhimeve)	të paktën 15 t	25
		të paktën 10 t	20
		të paktën 5 t	15
3	Përdorimi i prodhimeve të grumbulluara/prodhuara në Kosovë	po	17
		jo	7
4	Moshë e fermerit	nën 40	4
		40 e më shumë	2
5	Gjinia	femër	4
		mashkull	2
Totali maksimum			100

Sqarim: Në rast të numrit të njëjtë me pikë të projekteve të fundit, atëherë përparësi kanë projektet që kanë grumbulluar sasi më të madhe. Nëse edhe sasia është e njëjtë, atëherë do të zbatohet parimi: 'kush aplikon i pari, shërbehet i pari'.

8. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 90 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat me të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal

9. Treguesit e monitorimit dhe vlerësimi

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	300,000	
Outputi	Vlera e përgjithshme e investimeve	428,571
	Numri i përfituesve të mbështetur	20
Rezultati	Sasia e rritur dhe cilësia e përmirësuar e prodhimeve	
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar, ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	

10. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmase janë:

300,000

■ Nënmasa

Mekanizëm bujqësor

1. Arsyeshmëria e masës

Modernizimi i mekanizimit bujqësor ndikon në shfrytëzimin e resurseve natyrore - bujqësore, që nënkupton shfrytëzimin e tokës dhe inputeve bujqësore me efikasitet më të lartë duke ndikuar në uljen e humbjeve në fazat e ndryshme të prodhimit të kulturave bujqësore.

Kontributi i mekanizimit bujqësor është i njohur edhe në rritjen e prodhimit, sidomos nëse aplikohen së bashku me inpute (farërave me potencial prodhues, plehrave dhe pesticideve) dhe përdorim të ujitjes.

Aplikimi i mekanizmit modern në bujqësi ndikon në rritjen e prodhimit të kulturave të ndryshme, për të ndikuar po ashtu edhe në përmirësimin e afateve kohore të operimeve me saktësi dhe cilësi të përdorimit të inputeve.

2. Objektivi specifik i nënmasës

- Rritja e prodhimit të së përgjithshme dhe e prodhimit me kosto më të ulët;
- Rritja e efikasitetit të punës;
- Përmirësimin e cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Përmirësimin e kushteve të punës.

3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit

- Aplikuesit për mekanizim të lidhur me ndonjë nënmasë të Masës 2, duhet të respektojnë pragun minimal të sipërfaqes apo të numrit të kafshëve që është paraparë në çdo nënmasë. Në rast të aplikimit për mekanizim për lavërtari sipërfaqja minimale për aplikim është 2 hektar tokë punuese në pronësi të vet.

Dispozita tjera

- Për të njëjtën makinë ose pajisje mund të aplikohet vetëm në një nënmasë;
- Kërkesa për një makinë ose pajisje të caktuar duhet të jetë në pajtim me madhësinë e fermës;
- Kthimi i investimeve më së shumti për 10 vjet, llogaritur sipas udhëzuesit të MBPZHR-së për plan biznesi.

4. Investimet e pranueshme

4.1 Mekanizmi i sektorit të dritharëve

- Traktorë të prej 75 kw dhe të mëdhenj ;
- Plugje;
- Trina;
- Pjatore;
- Makina mbjellëse për-misër;
- Spërkatëse;
- Makina për shpërndarjen e plehut - me traktor të lehtë;
- Makinë për tharjen e misrit;

- Makina për nxjerrjen e patates dyrëndeshe.

4.2 Sektori i perimekulturës

- Makina mbjellëse për specat dhe lakër.

4.3 Sektori për blegtori

- Traktorë të prej 75 kw dhe të mëdhenj
- Presë për balosje në forme kubike;
- Rrotoballerë;
- Makina për zhvoshjen e misrit;
- Makina për silazhim;
- Autokombajnë për silazh;
- Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik;
- Rimorkio për transport;
- Makina për kositje;
- Makina për rrotullimin e barit;
- Përzierëset.

4.4 Sektori për pemëtari-vreshtari

- Traktorë të prej 75 kw dhe të mëdhenj
- Makina për mullqerim;
- Atomizerë;
- Shpërndarësi i pluhurit me 5 - 7 hulli;
- Kultivatorë këmbëpate për vreshta.

5. Dokumentet specifike për këtë nënmasë:

- Dëshmi për sipërfaqen dhe/ose për numrin e kafshëve që posedon.

6. Niveli maksimale i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

- Investimi maksimal i pranueshëm për një aplikues është: 100,000 €;
- Intensiteti i mbështetjes publike është: 65% e shpenzimeve të pranueshme.

7. Kriteret e përzgjedhjes

A) Kriteret e përzgjedhjes për lavërtari:

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë
1.	Projektet që përmbajnë traktorë	Po	45
		Jo	35
2.	Projektet që përkrahin ferma të mëdha dhe konkurrencte (ha)	mbi 20.00 ha	25
		15.01 - 20.00	22
		10.01 - 15.00	19
		5.01 - 10.00	16
		2.00 - 5.00	13
4.	Aplikuesi ka më shumë se 50% të tokës në pronësi	Po	10
		Jo	4
5.	Mosha e fermerit	Deri në 40 vjet	10

		40 e më shumë	8
6.	Gjinia (siç është regjistruar në regjistrin e fermës)	femër	10
		mashkull	8
Total			100

B) Kriteret e përzgjedhjes për nënsektorët e bujqësisë përpos lavëtarisë:

Nr.	Lloji i kriterit	Kategoria e kriterit	Pikë
1.	Projektet që përmbajnë traktorë	Po	45
		Jo	35
2.	Madhësia e fermës (përmbushja e njërit nga kushtet)	Së paku 3 ha me pemishte	25
		Së paku 0.5 ha me fruta të buta	
		Së paku 1 ha për perime në fushë të hapur	
		Së paku 1,000 m ² për serra	
		Së paku 3 ha vreshta	
		Së paku 24 lopë qumështore	
		Së paku 50 viça	
		Së paku 10 ha tokë bujqësore	
		Së paku 100 dele	
		Më pak se vlerat e lartshënuara	
3.	Më pak se 50% të tokës me qira	Po	10
		Jo	4
4.	Mosha e fermerit	Nën 40 vjet	10
		40 e më shumë vjet	8
5.	Gjinia (siç është regjistruar në regjistrin e fermës)	Femër	10
		mashkull	8
Total			100

8. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 90 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat me të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

9. Treguesit e monitorimit dhe vlerësimi

Lloji i indikatorit.	Indikatori	Caku
	1. Mekanizimi 1,300,000 €, të ndara si më poshtë:	
	- 700,000 € për lavërtari;	
	- 600,000 € për nënsektorët tjerë.	
Outputi	Numri i përfituesve, nga të cilat	130
	1. Ferma lavërtarë	70
	2. Fermat ë tjera	60
	Vëllimi total I investimit (në €), si vijon:	1,922,000
	1 Ferma të modernizuara lavërtarë	1,078,000
	2. Ferma tjera të modernizuara	844,000
Rezultati	Sipërfaqe të tokës lavërtarë me prodhimtari të shtuar (ha)	490
	Sipërfaqe tjera bujqësore me prodhimtari të shtuar (ha)	27
	Lopë qumështore në ferma me prodhimtari të përmirësuar	264
	Viça në ferma me prodhimtari të përmirësuar	550
Impakti	Prodhimi bujqësor i shtuar (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar, ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	

10. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë nënmasë janë:
1,300.000

Shënim:

Një aplikues mund të aplikojë vetëm në një masë brenda këtij programi.

MASA 3

Ujitja e tokave bujqësore

1. Arsyeshmëria e masës

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme, një nga prarësit kryesore të Qeverisë së Kosovës, nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes.

Derisa në stinët tjera të reshurat janë të mjaftueshme, ato mungojnë gjate stinës së verës. Prandaj shtrohet nevoja e akumulimit të ujërave me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjate verës për nevojat e ujitjes së kulturave bimë.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendët, rezervuarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat etj., kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja, si dhe për mirëmbajtje të rregullt.

Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lire, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse kihen parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe ato që parashikohen.

2. Objektivat e përgjithshme

- Rritja e prodhimit;
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore.

3. Objektivat specifike

- Sigurimi i ujit për ujitje të tokave bujqësore;
- Shtrirja e sistemit për ujitje në sipërfaqe sa më të mëdha të tokës bujqësore;
- Menaxhimi i suksesshëm dhe afatgjatë i sistemeve të ujitjes.

4. Lidhje me masat e tjera të përfshira në program

Masa 3 ka ndikim të madh në mbarëvajtjen e Masës së 2, në investimet e ekonomive bujqësore.

5. Kriteret e pranueshmërisë

- Përfituesit e mundshëm janë: fermerët si persona fizik apo persona juridik, grupet e shoqatave të fermerëve, shoqatat e ujitjes, etj.;
- Statusi ligjor i pronës në të cilën do të ndërtohet sistemi i ujitjes duhet të jetë i qartë;
- Duhet të ekzistojë zotimi në parim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit;
- Sipërfaqja minimale nën ujitje e projektit: 2 ha;
- Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës, që fermeri e nënshkruan me Agjensinë e Zhvillimit të Bujqësisë

6. Shtrirja gjeografike

Në tërë territorin e Republikës së Kosovës

7. Investimet e pranueshme

- rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës ekzistuese të ujitjes;
- hapja e puseve;
- ndërtimi i rezervarëve të ujit për ujitje;
- kyçje në kanale të furnizimit publik;
- blerja e pompave dhe pajisjeve përcjellëse;
- shtrirja e rrjetit të gypave për sistemin e shpërndarjes së ujit;
- hapja dhe ndërtimi i kanaleve sekondare për ujitje;
- pajisjeve për matjen e ujit, pajisjet për kontrollin e rrjedhjes;
- punët përcjellëse me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit).

Aktivitetet e mëposhtme përgatitore dhe mbikëqyrëse janë të pranueshme për përkrahje:

- Skicat/ dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik;
- Vlerësimi i ndikimit mjedisor;
- Përgatitja e dokumenteve të aplikimit.

Një aplikues nuk mund të aplikojë vetëm për financim të aktiviteteve të lartpërmendura. Aplikimi duhet të jetë i përfshirë në tërë projektin dhe përmban aktivitetet përgatitore dhe shpenzimet e investimit lidhur me ndërtimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

8. Dokumentet e nevojshme

- Formulari i aplikimit me projekt propozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- Plani i biznesit si pjesë e formularit për aplikim për projektet në vlerë mbi 20,000 €;
- Kopje e një llogarie bankare të vlefshme;
- Kopja e certifikatës së biznesit nëse është biznes;
- Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar (përfaqësues të biznesit).

a) Pas përzgjedhjes së projektit, kërkohet:

- Kopja mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor nga MMPH.

9. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

Kosto minimale e investimit të pranueshëm: 5.000 €;

Kosto maksimale e investimit të pranueshëm : 100.000 €.

Intensiteti i mbështetjes publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme.

10. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme janë:

- artikujt tashmë të financuar në kuadër të ndonjë kornize tjetër;
- blerja e tokës apo ndërtesave;
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerisë;
- tatimet, përfshirë TVSH-në, përveç nëse përfituesi (apo partnerët e përfituesit) nuk mund t'i kthejnë ato dhe rregulloret në fuqi nuk ndalojnë mbulimin e tatimit;
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në natyrë;
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimi);
- shpenzimet operative;
- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera.

11. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteri	Parametri	Pikë
Efiçienca e ujitjes për sipërfaqe	Metoda e kalkulimit: Të gjitha projektet teknike duhet të përmbajnë koston e ujitjes për hektar. Pas vlerësimit të të gjitha projekteve, nga projektet e pranueshme do të krijohet një listë në bazë të koston së ujitjes për hektar duke filluar nga projekti me koston më të vogël i cili do të marrë maksimumin e pikëve dhe projekti me koston më të lartë i cili do të marrë zero pikë. Projektet në mes do të marrin pikë përpjesëtimisht, duke u bazuar në këtë kriter (duke përdor shifra me dy decimale pas presjes)	Max. 30
Sipërfaqja e ujitur (ha)	2-5	10
	5,01 - 10,00	15
	10,01-15,00	20
	15,01 - 20,00	25
	Më shumë se 20	30
Numri i fermerëve që përfitojnë nga projekti	Deri në 10	10
	11-20	15
	Më shumë se 20	20
Në projekt ka prodhues me projekte të miratuara nën Masën 2	Deri në 5	10
	Më shumë se 5	20
Totali		100

12. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 60 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit. Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

13. Treguesit e monitorimit dhe vlerësimi

Lloj i treguesit	Treguesi	Caku
Inputi	1.000.000	
Outputi	Vlera e përgjithshme e investimeve	1.300.000
	Numri i përfituesve të mbështetur	19
Rezultati	Sipërfaqet e reja të ujitura	
	Prodhimi i shtuar si rezultat i investimit	
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar, ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	

14. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë masë janë:

1,000,000 €

Shënim:

Një aplikues mund të aplikojë vetëm në një masë brenda këtij programi.

MASA 4

Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Prodhimeve Bujqësore

1. Arsyeshmëria e masës

Aktualisht përpunimi i prodhimeve të qumështi, mishit, frutave, perimeve dhe rrushit janë në nivel mjaftë të ulët. Shumica e prodhimeve janë sjellë në tregun lokal pa u përpunuar. Krijimi i një vlere të shtuar ka një potencial të madh për të rritur të ardhurat e fermerëve, për të diversifikuar ekonominë dhe zhvillimin e përgjithshëm të bujqësisë.

Kjo masë është projektuar për të plotësuar ndërhyrjet në Masën 2, duke synuar një furnizim në rritje të prodhimeve bujqësore vendore.

Për të konkurruar me sukses në një treg gjithnjë e më të hapur industria e përpunimit të ushqimit ka nevojë për modernizimin e teknologjive dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë. Industria ushqimore duhet të sigurojë transportin, grumbullimin, magazinimin e lëndëve për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e ushqimit.

2. Objektivat specifike

- Të rrisë kapacitetin e përpunimit dhe prodhimtarinë, duke zbatuar teknologjitë moderne;
- Të përmirësoj higjienën dhe cilësinë e standardeve vendore për përpunimin e prodhimeve agro-ushqimore;
- Të inkurajojë përdorimin e teknologjive të reja që e ruajnë mjedisin.

3. Lidhje me masat e tjera të përfshira në program

Masa 4 është duke plotësuar Masën 2 në investimet e ekonomive bujqësore që çojnë në plotësimin e njera - tjetres.

4. Kriteret e pranueshmërisë

Aplikuesit duhet:

- Të jenë persona juridik të regjistruar në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve;
- Personat fizik mund të aplikojnë vetëm si fillestar.
- Aplikuesit e projekteve investuese në vlerë mbi 20.000 € duhet të dorëzojnë plan biznesi sipas formatit të kërkuar nga MBPZHR si pjesë e aplikacionit. Në rast të punëve të ndërtimit dhe/ose rindërtimit, dokumentacioni teknik me plan të ndërtimit dhe/ose rindërtimit, duhet të përgatitet dhe të dorëzohet bashkë me planin e biznesit;
- Përfituesit e projekteve në të cilat niveli i përkrahjes me mjete publike është 30,000 € apo më shumë, pas nënshkrimit të kontratës me Agjensionin për Zhvillimin e Bujqësisë duhet të regjistrojnë ndërmarrje bujqësore në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve;
- Të jetë i regjistruar në Agjensionin për Regjistrimin e Biznesit - me përjashtim të bizneseve fillestare të cilët kanë të drejtë të konkurrojnë, dhe regjistrimi bëhet pas nënshkrimit të kontratës;
- Të jetë operacional në Kosovë për 2 vitet e fundit/të vërtetohet në bazë të aktit të regjistrimit ose një dokument të kontabilitetit që tregon një aktivitet të zhvilluar dy-vjeçar, përveç se për fillestarët, me që rast zbatohen rregullat për personat fizikë;
- Të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për menaxhimin e agrobiznesit (jo si një ndërmjetës);

- Dokumentacioni teknik për ndërtim ose rindërtim të objektit të planifikuar (në rast të ndërtimit ose rindërtimit), të jetë i përgatitur dhe i dorëzuar bashku me Planin e Biznesit;
- Me nënshkrimin e kontratës të jetë i obliguar për të marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga projekti i Bankës Botërore para se pagesa përfundimtare të jetë miratuar;
- Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjensionin e Zhvillimit të Bujqësisë.

5. Shtirja gjeografike

Në tërë territorin e vendit.

6. Kriteret specifike të pranueshmërisë

Për sektorët e përpunimit të qumështit, mishit dhe thertoret, përfituesi duhet të përfshihet në kategoritë A, B dhe C të listës së kategorizimit të objekteve për përpunimin e ushqimit, të përgatitura nga Agjensioni Kosovar i Ushqimit dhe të publikuar në faqen e internetit. Bëjnë përjashtim bizneset fillestare të cilët janë në proces të regjistrimit.

7. Kriteret e përbashkëta me të drejtë mbështetje dhe investimet e pranueshme për sektor

Investimet e pranueshme janë: përpunimi dhe marketingu i prodhimeve bujqësore, siç janë; qumështi, mishi, pemë, perime dhe rrushi.

Investimet në nivelin e shitjes me pakicë nuk kanë të drejtë të përfshihen në këtë masë.

Vetëm investimet që bëhen pas nënshkrimit të kontratës mund të konsiderohen të vlefshme për rimbuesim nga Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë, me përjashtim të studimeve të fizibilitetit dhe shpenzimeve tjera konsultative, që kanë lidhje me përgatitjen e aplikacionit.

Investimi i cili përkrahet duhet të jetë në pajtim me standardet relevante nacionale.

8. Investimet e pranueshme

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve/investimeve që janë relevante në industrinë e ushqimit, për prodhimet e qumështit, mishit, pemëve, perimeve dhe të verës:

A. Prodhimet e qumështit

Paragr.	Aktivitetet/investimet
01	Grumbullimi dhe ruajtja e qumështit;
01	Konstruktimi i qendrave të reja të grumbullimit, ri-konstruktimi ose instalimi në qendrat ekzistuese të grumbullimit;
02	Blerja dhe instalimi i mjeteve për ruajtjen dhe ftohjen e qumështit;
03	Blerja e mjeteve dhe teknologjisë për testimin dhe analizën higjienike dhe cilësisë së qumështit;
04	Shërbimet për themelimin e sistemeve për ruajtjen e ushqimit (GHP, HACCP);
05	Blerja dhe instalimi i IT hardware edhe software për regjistrimin, monitorimin, kontrollimin dhe menaxhimin e qumështit;
02	Përpunimi i qumështit;

01	Konstruktimi, ri-konstruktimi ose instalimi i mjeteve për përpunimin e qumështit, duke përfshirë edhe laboratorët brenda fabrikave;
02	Blerja e mjeteve për grumbullimin dhe ruajtjen e qumështit (cisternat për ruajtjen e qumështit, pompat e qumështit, transformuesi i nxehtësisë së qumështit dhe cisternat ftohëse për ruajtjen e qumështit);
03	Blerja e mjeteve për homogjenizimin dhe pasterizimin e qumështit (pasterizuesit, transformuesit e nxehtësisë, homogjenizuesit, ndarësit e të tjera të ngjashme);
04	Blerja e mjeteve për prodhimin e prodhimeeve të qumështit;
05	Blerja e makinerisë dhe mjeteve për sistemet e paketimit të prodhimeve (matja automatike për gram, mbushja, paketimi, etiketimi dhe tjera të ngjashme);
06	Blerja e makinerisë dhe mjeteve për ruajtjen e prodhimeve;
07	Blerja e mjeteve, pajisjeve për monitorimin e sigurisë së ushqimit, incizimin dhe konfirmimin e pikave kritike të kontrollit (pH metrat, matësi i temperaturës/pajisjet vëzhguese, pajisjet kohore, njësitë matëse të temperaturës, detektorët për metal, magnetet, matja e rrjedhës, etj);
08	Blerja e mjeteve dhe instrumenteve laboratorike;
09	Blerja e makinerisë dhe mjeteve për mbetjet e ujit/objektet e pastrimit; Përmirësimi i linjës për hedhjet e mbeturinave të lëngshme si dhe ruajtja dhe heqja e mbeturinave të ngurta;
10	Teknologjitë për ruajtjen e energjisë;
11	Blerja e mjeteve speciale për transport: Kamionë frigorifer; Mjete speciale për transportin e qumështit;
12	Blerja dhe instalimi i IT hardware dhe software për prodhime dhe procesin e menaxhimit (regjistrimin e qumështit, menaxhimin e përgjithshëm të ndërmarrjes);
13	Shërbimet për informimin lidhur me sistemet e sigurisë së ushqimit (ISO, GHP, HACCP).

B. Mishi dhe përpunimi i mishit

Paragr.	Aktivitetet/investimet
01	Thertoret
01	Ndërtimi/rindërtimi i thertoreve;
02	Blerja e mjeteve për thertore:
	Mjete për shkarkimin dhe vijën e gjakderdhjes;
	Mjete kulluese;
	Mjete për heqjen dhe transferimin e kafshëve;
	Makineri dhe mjete për heqjen e lëkurës dhe transportim;
	Kabinat e larjes dhe mjete transporti;
	Kabinat e prerjes dhe mjetet për largimin e eshtrave;
	Larja, pastrimi dhe transportimi i makinerisë dhe mjeteve;
	Grumbullimi i mbetjeve dhe transportimi i mbetjeve;
Ekzaminimi i platformës para therjes dhe mjetet në sallat e pritjes së kafshëve;	

	Ekzaminimi i platformës dhe aparaturës pas thirrjes;
	Pajisjet e marrjes së mostrave sipas BSE ekzaminimit;
	Mjetet e pastrimit dhe dezinfektimit;
	Sistemet e hekurudhave me një shin;
	Sistemet e djegies;
	Incinëratoret;
03	Blerja e mjeteve të specializuara të transportit:
	Kamion për transportimin e kafshëve të gjalla sipas rregullave për mirëqenien e kafshëve;
	Kamion frigorifer për transportin e mishit;
04	IT e specializuar hardware dhe software për monitorim, kontrollim dhe menaxhim;
05	Shërbimet për njoftimin dhe informimin lidhur me sistemet për sigurinë e ushqimit (GHP, HACCP);
02	Njësiti për përpunimin e mishit
01	Blerja e mjeteve, pajisjeve për ruajtjen e ushqimit, monitorimin, vëzhgimin dhe konfirmimin e pikëve kritike të kontrollit (p.sh. matësit, matësit e temperaturës/pajisjet e vëzhgimit, pajisjet kohore, njësiti kontrolluese të temperaturës, detektorët e metaleve, magneteteve, matja e rrjedhjes etj.;
02	Përmirësimi i linjës për hedhjet e mbeturinave të lëngshme, si dhe ruajtja dhe heqja e mbeturinave të ngurta; Blerja e makinerisë dhe mjeteve për trajtimin e mbetjeve të lëngshme/objektet e pastrimit;
03	Shërbimet për informimin lidhur me sistemet e sigurisë së ushqimit (GHP, HACCP);

C Sektori i përpunimit dhe marketingut të frutave dhe perimeve duke përfshirë edhe prodhimin e verës

Paragrafi	Aktivitetet/investimet
01	Ndërtimi ose rindërtimi i objektit, duke përfshirë edhe strukturat instaluese para fabrikimit të njësive që merren me përpunimin e pemëve dhe/ose perimeve;
02	Ndërtimi ose rindërtimi i objektit duke përfshirë edhe strukturat instaluese para fabrikimit të njësive që merren me trajtimin pas vjeljes dhe/ose ruajtjen e prodhimeve të papërpunuara, ruajtjen dhe paketimin;
03	Blerja e vijave për ruajtjen/pasterizimin ose tharjen e pemëve dhe perimeve;
04	Blerja e mjeteve për paketim dhe etiketim, vijat mbushëse, mbështjelljet, etiketimet dhe mjete të tjera të specializuara për këtë veprimtari;
05	Blerja e mjeteve për trajtimin pas vjeljes për ruajtjen e prodhimeve të papërpunuara, larjen, pastrimin, seleksionimin, përzgjedhjen, vlerësimin, prerjen, tharjen dhe paketimin e pemëve dhe perimeve të freskëta;
06	Blerja e makinerisë dhe mjeteve për para-ftohje, njësiti ftohëse dhe depot e ftohjes.;
07	Blerja e mjeteve për ftohje duke përfshirë një depo të thellë dhe të madhe, tunele ngrirës dhe mjete të tjera të nevojshme, në mënyrë që të sigurohet ftohja në tërë zinxhirin ftohës;

08	Blerja e mjeteve, pajisjeve për monitorimin e sigurisë së ushqimit dhe konfirmimin e pikëve kritike të kontrollit (p.sh. matës, matësit e temperaturës/pajisjet e incizimit, pajisjet kohore, njësitë kontrolluese të temperaturës, detektorët për metal, magnete, matja e rrjedhës etj);
09	Teknologjitë për ruajtjen e ambientit dhe mjetet për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve;
10	Mjete ftohëse të specializuara për transport;
11	Teknologji për ruajtjen e energjisë duke përfshirë edhe ato për ripërtëritjen e energjisë;
12	IT hardware e software të specializuar për monitor.,kontroll. e menaxhim;
13	Shërbimet për njoftimin dhe informimin e cilësinë e ushqimit dhe sistemeve të sigurisë (ISO, GHP, HACCP);
Mjete specifike për prodhimin e verës	
01	Cisternë për stabilizimin e ftohjes së verës;
02	Mjete për stabilizimin e ftohjes së verës;
03	Filtër rrotullues me vakum;
04	Filtër vazhdues, me rrjedhje, i llaminuar dhe filtër të kombinuar;
05	Pompat e verës;
06	Seperator të centrifuges;
07	Nitro gjenerator;
08	Vija prodhuese për mbushjen e verës;
09	CIP (sistemi i pastrimit) stacioni;
10	Shtese pneumatike;
11	Tuba dhe pajisje.

D Investimet e pranueshëm për të gjitha nën sektorët e Masës 4

Paragrafi	Aktivitetet/investimet
01	Investimet në mjete e pajisje për pastrim, dezinfektim e siguri në punë;
	Punë konstruktuese të reja ose renovimin e banjave ekzistuese/dusheve/tualeteve/gardërobave dhe WC;
	Blerja e mjeteve për pastrimin dhe dezinfektimin e materialeve paketuese,mjeteve,pajisjeve,makinave (pastruesit me avull,larëseve me shtypje etj);
	Blerja e derës hyrëse/dalëse,dezinfektimin e njësive dhe/ose portave higjienike;
	Blerja e bojlerëve për prodhimin e ujit të nxehte dhe avullit;
	Blerja e mjeteve të dezinfektimit;
02	Blerja dhe instalimi i mjeteve dhe sistemeve të ngrohjes/ftohjes/ventilimit të ajrit/kondicionimin dhe ndriçimin;
03	Blerja e gjeneratorëve;
04	Blerja dhe instalimi i alarmit kundër zjarrit dhe vjedhjes/sistemeve të sigurisë, sistemeve të vëzhgimit (duke përfshirë edhe instalimet e tyre elektrike dhe lidhjet e tjera);
05	Blerja e sistemeve të bartjes dhe transportimit për përdorim të transportit të brendshëm (si: pirunjerat, rimorkiot, kontenjerat, furgonët, krani, kamion paletat, karrocet, etj.);
06	Konstruktimi për ndërtimin e rrethojave të reja/rrethojave mbrojtëse.

10. Shpenzimet e pranueshme për marketing për të gjithë nënsektorët

- Hartimi dhe shtypja e katalogëve, fletushkave, broshurave, posterave etj., për promovimin e prodhimit si rezultat i mbështetjes publike, por jo edhe shpërndarja e tyre;
- Prodhimi i audio dhe video spoteve, por jo edhe me shpërndarja e tyre mediale.

Shpenzimet maksimale të pranueshme për marketing janë të kufizuara në 10% nga investimet në ndërtesa dhe pajisje.

Në të gjitha materialet publicitare duhet të përmendet se investimet janë bërë me mbështetjen e MBPZHR-së, DANID-es dhe Bankës Botërore.

11. Dispozitat tjera në lidhje me shpenzimet e pranueshme në nënmasat e Masës 4

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara për:

- Ndërtimin ose përmirësimin/renovimin e pronës së paluajtshme;
- Blerjen e makinerisë dhe mjeteve duke përfshirë software kompjuterik sipas vlerës së tregut;
- Shpenzimet e operative, siç janë: studimet e fizibilitetit, arkitektët, ndërtimtarët, planin e biznesit e tarifën konsultative, deri në 5% të shpenzimeve të përmendura nën pikët e mëparshme, por jo më shumë se 5.000 €.

12. Shpenzimet e papranueshme

- Borxhet dhe provizionet për humbjet ose borxhet;
- Interesi i borxhit;
- Artikuj tashmë të financuar nga një kornizë tjetër;
- Blerja e tokave ose ndërtesave;
- Humbjet në këmbimin e valutave;
- Taksat duke përfshirë edhe TVSH, vetëm në qofte se përfituesi (ose partnerët e përfituesit), nuk mund të rikuperojnë dhe rregulloret në fuqi nuk ju ndalojnë atyre përfshirjen e taksave;
- Kreditë e palës së trete;
- Blerja e mjeteve të dorës së dytë;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzimet e amortizimit;
- Shpenzimet operacionale;
- Detyrimet bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- Detyrimet e doganës, importit dhe çdo detyrim tjetër.

13. Kriteret e përzgjedhjes

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes - Qumështi		Pikë
1.	Investimet në	Kritjen e kapacitetit të përpunimit dhe prodhimit;	30
		Përmirësimin e higjienës dhe standardeve të cilësisë;	20
		Teknologji për ruajtjen e mjedisit (menaxhimi i mbeturinave).	10
2.	Përdorimi i qumështit të papërpunuar nga fermerët lokal prej 90%;		20
	Nën 90%;		10

3.	Përvoja mbi 5 vite (10 pikë vlen për fillestartet);	10
	Më pak se 5 vite përvojë;	5
4.	Aplikuesi femër;	5
	Aplikuesi mashkull;	3
5.	Aplikuesi nën moshën 40 vjeçare;	5
6.	Aplikuesi mbi moshën 40 vjeçare;	3
Totali		100

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes - Mishi		Pikë
1.	Investimet në	Rritjen e kapacitetit të përpunimit dhe prodhimit	30
		Përmirësimin e higjienës dhe standardeve kualitative;	20
		Teknologjitë për ruajtjen e mjedisit (menaxhimi i mbeturinave);	10
2.	Përdorimi i lendeve të para (kafshëve) nga fermerët lokal mbi 60%;		20
	60% ose më pak;		10
3.	Përvoja mbi 5 vite (10 pikë vlen për fillestartet);		10
	Më pak se 5 vite përvojë;		5
4.	Aplikuesi femër;		5
	Aplikuesi mashkull;		3
5.	Aplikuesi nën moshën 40 vjeçare;		5
	Aplikuesi mbi moshën 40 vjeçare;		3
Totali			100

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes - Frutat, Perimet dhe Vera		Pikë
1.	Investimet në	Rritjen e kapacitetit të përpunimit dhe prodhimit	30
		Përmirësimin e higjienës dhe standardeve kualitative;	20
		Teknologjitë për ruajtjen e mjedisit (menaxhimi i mbeturinave);	10
2.	Përdorimi i lendeve të para nga fermerët lokal mbi 60 %;		20
	60% ose më pak;		10
3.	Përvoja mbi 5 vite (10 pikë vlen për fillestartet);		10
	Më pak se 5 vite përvojë;		5
4.	Aplikuesi femër;		5
	Aplikuesi mashkull;		3
5.	Aplikuesi nën moshën 40 vjeçare;		5
	Aplikuesi mbi moshën 40 vjeçare;		3
Totali			100

Sqarim: Në rast të numrit të pikëve të njëjta të projekteve, atëherë përparësi kanë projektet që kanë kapacitet më të madh të përpunimit. Në çiftë se edhe kapaciteti i është i njëjtë, atëherë aplikohet parimi: 'i pari aplikoni, i pari shërbehet'.

14. Niveli i mbështetjes

Intensiteti i ndihmës publike për shpenzimet e pranueshme	60 %
Shuma minimale e shpenzimeve të pranueshme për projektin e mbështetur;	30,000 €
Shuma maksimale e shpenzimeve të pranueshme;	333,333 €
Shuma minimale e shpenzimeve të pranueshme për projektin e bizneseve fillestare;	10,000 €
Shuma maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projektin e bizneseve fillestare;	25,000 €
Numri i aplikacioneve për aplikues.	Shënim: Një aplikues nuk mundë të paraqesë më shumë se një aplikim, sipas kritereve të kësaj mase.

15. Dokumentet përcjellëse

- Formulari i aplikimit me projektpropozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- Plani i biznesit si pjesë e formularit për aplikim;
- Kopja e certifikatës së biznesit;
- Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar (përfaqësues të biznesit);
- Dokumenti i Regjistrimit si operator i ushqimit;
- Kopje për kategorinë e themelimit;
- Kopje e një llogarie bankare të vlefshme;
- Kopjen e kontratave me fermerët lokal-furnizuesit.

Pas përzgjedhjes së projektit, kërkohet:

- Leja e ndërtimit e lëshuar nga organi kompetent komunal (në rastin e ndërtimit);
- Kopjen mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor (nga MMPH).

16. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 60 ditë nga data e publikimit.

Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen nëpërmjet transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 € duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

17. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku	
Të dhënat	3,000,000 €		
Përfundimi	Nr. i ndërmarrjeve që janë mbështetur	33	
	Prej të cilave	Prodhimet e qumështit	11
		Përpunimi i mishit	11
		Fruta perime dhe vera	11

	Nr. i ndërmarrjeve fillestare që janë mbështetur	11
	Vëllimi i përgjithshëm i investimeve (€)	5,150,000
Rezultati	Numri i përpunuesve me investimet në rritjen e kapaciteteve të prodhimit	42
	Numri i përpunuesve me investimet në përmirësimin e higjienës dhe standardeve kualitative.	40
	Numri i përpunuesve me investimet në teknologji miqësore për mjedisin (menaxhimi i mbeturinave)	37
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (€)	
	Numri total i vendeve të reja të punës që janë krijuar, ekuivalente me vende të punës me orar të plotë	

18. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë masë janë:

- Buxheti vjetor i Masës 4 është 3.000.000 €, i ndarë në sektorë, siç vijon:

Sektori	Buxheti vjetor	Prej të cilave për fillestar
Qumësht	1.000.000 €	50.000 €
Mish	1.000.000 €	50.000 €
Fruta, Perime dhe Prodhimtaria e Verës	1.000.000 €	50.000 €

Në rast të mos shfrytëzimit të buxhetit në një nënmasë, Autoriteti Menaxhues vendos për shfrytëzimin e tij në një masë ose nënmasë tjetër.

Shënim:

Një aplikues mund të aplikojë vetëm në një masë brenda këtij programi.

MASA 8

Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal

1. Arsyeshmëria e masës

Mbështetja për zhvillimin e komunitetit në nivel lokal, sipas Masës 8, do të bazohet mbi dy parime:

- Vendimet e marra nga një komunitet lokal ka më tepër gjasa që të plotësojnë nevojat e atij komuniteti;
- Një komunitet që investon kohën dhe përpjekjet e veta në modelimin, zhvillimin apo dhënien e projekteve që adresojnë prarësitë e zhvillimit rural lokal ka më tepër gjasa që ta përdorë dhe ta mirëmbajë atë shërbim që do të sigurohet me këto projekte.

Prioritete të tilla identifikohen nëpërmjet projekteve për zhvillimin lokal të përpiluar nga Grupet Lokale të Veprimt (GLV) që përbëhen nga partneriteti i personave të administratës lokale, biznesit dhe shoqërisë civile.

2. Objektivat

Objektiva e përgjithshme e Masës 8-të është t'u ofroj përkrahje në:

- Programe të bazuara në zona që kanë për qëllim identifikimin e mirë të territoreve rurale nënrajonale;
- Implementimin e projekteve bashkëpunuese, veçanërisht zonave ndërkufitare dhe zhvillimeve rajonale;
- Implementimin e qasjeve të reja dhe pilote;
- Partneritetit lokal publik-privat - GLV;
- Rrjetëzimin e partneriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
- Qasja globale shumësektoriale e bazuar në ndërveprimin ndërmjet aktorëve dhe projekteve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale;
- Qasjeve nga poshtë lart me fuqitë për vendimmarrje për grupet vepruese lokale (GVL) për sa i përket elaborimit dhe implementimit të strategjive zhvilluese lokale;

3. Lidhja me masat tjera të përfshira në program

Zbatimi i suksesshëm i kësaj mase kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe i shërben arritjes së objektivave të Masës 1. Gjithashtu zbatimi i kësaj mase do t'i shërbejë arritjes së objektivave të Masës 3, po ashtu zbatimi i kësaj mase do të plotësojë aktivitetet që do të zbatohen në Masën 5. Aktivitetet e Masës 8 gjithashtu do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me Masën 6 dhe Masën 7.

4. Lloji i investimit të pranueshëm

1. Infrastruktura bujqësore dhe rurale;
2. Rregullimi i oborreve shkollore (rrethoja, ujësjellësi, fontana, parku i shkollës, hapja e puseve, fusha sporti);
3. Rregullimi i parqeve (investim i pranueshëm do të jetë gjithçka që është e nevojshme për rregullimin e parkut, përfshirë këndin e lojërave për fëmijë dhe terrenet sportive);

4. Rregullimi i varrezave (investim i pranueshëm do të jetë gjithçka që është e nevojshme për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave përfshirë edhe rregullimin e rrugës deri tek varreza);
5. Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumenjve;
6. Ndërtimi i ndonjë ure me interes të përgjithshëm;
7. Rregullimi i rrugëve rurale dhe fushore me karakter të përdorimit të gjerë (investim i pranueshëm e mbuluar me faturat e lëshuara nga një kompani e punëve përkatëse si kryese e punimeve);
8. Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në zona rurale;
9. Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura;
10. Përkrahje e ekspozitave me karakter bujqësore dhe artizanale;
11. Përkrahje e projekteve me karakter zhvillimore ndërkufitar dhe manifestimeve ndërkufitare.

Kostot e pranueshme janë të gjitha investimet që janë të faturuara prej kompanive të cilat janë të angazhuara për kryerjen e aktiviteteve!

5. Dokumentacioni i nevojshëm

1. Projekti investues i cili duhet të përmbajë formë standarde të përmbajtjes së projektit;
2. Certifikata e regjistrimit të GLV-së;
3. Certifikata e numrit fiskal të GLV-se
4. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të GLV-së;
5. Dëshmia e sigurimit të 30% të investimeve nga kuvendet komunal, komuniteti, bizneset private, etj. (dëshmi nga kryetari i komunës ose përgjegjësi në sektorin financiar, nga biznesi privat bartësi i biznesit, bankës, kompanisë ose nga komuniteti me nënshkrim të të gjithë të interesuarve).
6. Dëshmia e shlyerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj rrjetit të GLV-ve;
7. Përfituesit duhet të kenë të hapur llogarinë të vlefshme bankare në emër të GLV-së;
8. Përfituesit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrat e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike.

6. Niveli i mbështetjes intensiteti i ndihmave

Shpenzimet e projektit të pranueshme janë:

- a) minimumi 1.000€ dhe
- b) maksimumi 25.000€.

Intensitet i ndihmës publike është 70%.

GLV-se i lejohet si shpenzim i pranueshëm - shpenzimet operative 7 % nga totali i kostos së projektit!

Shpenzimet operative.

Shpenzimet operative (të gjitha shpenzimet e operative duhet të sigurohen faturat) përfshijnë:

1. shpenzimet e faturimit;
2. shpenzimet zyra (Materiali për zyre) dhe furnizimet;
3. shërbimet, të tilla si telefon, faksi dhe interneti;
4. shpenzimet e udhëtimit dhe të automjetit (Shpenzimet e udhëtimit përfshijnë shpenzimet strehim si dhe shpenzime për ushqim);

5. reklamat;
6. mëditje.

Nëse shpenzimet e investimeve të pranueshme janë me të larta se 25.000 €, atëherë mbi këtë shumë përfituesit duhet të ofrojnë mjetet e veta financiare për t'i mbuluar shpenzimet.

Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që përfituesi e nënshkruan me Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë:

7. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme janë:

- Taksat;
- Taksat e doganës dhe importit ose ndalesat tjera;
- Blerjet, qiratë ose lizingun e tokës ose ndërtesave ekzistuese;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
- Shpenzimet për blerjen e pajisjeve të përdorura;
- Ndalesat bankare, shpenzimet e garancive dhe ndalesat e ngjashme;
- Shpenzimet për operim dhe mirëmbajtje;
- Shpenzimet e bëra para publikimit të procedurës përkatëse të tenderimit;
- Shpenzimet në mall.

Përfitues të kësaj mase janë komuniteti lokal në viset rural.

8. Kriteret e përzgjedhjes të projekteve të GLV

Nr	Kriteret	Pikë	totali
1.	Numri i përfituesve nga projekti i GLV		
1.1	Deri në 200	30	
1.2	Mbi 200	40	
			40
2.	3. a) Jetëgjatësia e projektit për investimet nën 1,2,3,4,5,6,7,8,9 dhe 11		
2.1	Njëvjeçar	5	
2.2	Pesëvjeçar	10	
2.3	Mbi pesëvjeçar	15	15
	3.b) Numri i personave të synuar		
	Deri në 100 persona	5	
	100 e më shumë persona	10	
	Më shumë se 200 persona	15	15
3.	GLV që kanë qenë aktive gjate viteve paraprake		
	3.1 Asnjë projekt	20	
	3.2 Një projekt	15	
	3.3 Më shumë se një projekt	10	20
4.	4.1 Ndikimi në mjedis (ka)	10	10
	4.2 Ndikimi në mjedis (nuk ka)	5	
Totali			100

9. Përfituesit e mundshëm

- Personat juridik (GLV), të cilët janë të regjistruar në regjistrin e OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike

10. Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas vlerësimit të kriterëve për përzgjedhje.

Investimi duhet të kryhet në afat prej 90 ditëve nga data e aprovimit të projektit; Pagesa dëshmohet me transfer bankar për shpenzimet mbi 500 €. Shpenzimet nën 500 € dëshmohen me fature dhe kupon fiskal.

11. Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Input	200.000 €.	
Output	Nr. i GLV të përkrahur;	12
	Vëllimi i përgjithshëm i investimit (në €);	285,740
Rezultati	Nr. Parqe të rregulluar; Nr. Terrenet sportive të rregulluar; Nr. Shtretër të lumenjve të pastruara; Nr. Fontana funksionale; Nr. Panaireve të organizuar bujqësore/tradicionale; Nr. Urave të ndërtuar; Km. Të rrugëve rurale të shtruara; Ha. Të sipërfaqeve të pyllëzuara; Nr. I rrethojave të shkollave të rregulluara etj.	Rritje për 5% në krahasim me vitin 2010
Ndikimi	Përmirësimi i kushteve të jetesë në zonat rurale	Rritje për 2% në krahasim me vitin 2010

Shënim:

GLV mund të aplikoj me më së shumti dy projekte.

Projekti i dytë pranohet pasi që të jenë shërbyer të gjitha GLV-të me projekte të para, nëse i plotësojnë kushtet e kërkuara me thirrjen për aplikim.

12. Mjetet financiare

Mjetet financiare për këtë masë:
200,000 €

Tabela e buxhetit të masave të propozuara

Tabela e buxhetit të masave të propozuara		
	Masa 2 Ristrukturimi i Potencialit Fizik në Sektorin Agro-Rural	6,650,000 €
	Nënmasat	
a)	Sektori i qumështit:	1,000,000 €
b)	Sektori i vezëve:	300,000 €
c)	Sektori i mishit:	700,000 €
ç)	Sektori i bletarisë:	250,000 €
d)	Sektori i pemëve:	1,200,000 €
dh)	Sektori i rrushit të tryezës:	200,000 €
e)	Sektori i perimtarisë:	1,400,000 €
ë)	Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese:	300,000 €
f)	Sektori i makinerisë bujqësore:	1,300,000 €
	Masa 3 Ujitja e tokave bujqësore:	1,000,000 €
	Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Prodhimeve Bujqësore:	3,000,000 €
	Masa 4 Investimet në Përpunim dhe Marketingun e Prodhimeve Bujqësore / Ndërtimi i Depove:	2,500,000 €
	Masa 8 Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal:	200,000 €
	Zona më pak të favorizuar:	1,500,000 €
	Totali	14,850,000 €